



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



Basic Education Program

SEMINARI NJË EDUKIMI CILËSOR Pikëpamja e përgjithshme



Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë doracak nuk i reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Ky doracak është financuar nga populli amerikan përmes Agjencionit të SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID Kosovë), në kuadër të Programit për Arsimin Themelor (Basic Education Program) të USAID-it të cilin e zbaton Family Health International (FHI 360) në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës (MASHT) dhe Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC).

Basic Education Program

SEMINAR NJË: PJESA E PARË EDUKIMI CILËSOR Pasqyra e përgjithshme

'Seminari i Parë' i adreson disa aspekte të standardeve të praktikës profesionale të drejtorëve të shkollave. Në mënyrë të drejtpërdrejtë seminari adreson standardet 1, 2, 5 dhe 6 përmes temave në vijim:



MIRËNJOHE:

Programi për Arsim Themelor (Basic Education Program) i financuar nga Agjencioni i SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Qeveria e Kosovës i është mirënjohës Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH për shfrytëzimin e Programit të saj për trajnimin e drejtorëve të shkollave (2012). Gjithashtu, projekti i është mirënjohës edhe autorëve dhe bashkërenduesve të Programit të trajnimit të drejtorëve të shkollave: Dr. Hermann Scheiring, Carmen Mattheis, Selim Mehmeti, Vesel Hoda dhe Sokol Elshani. E gjithë përmbajtja në kuadër të materialit të seminarit, përveç seksionit të parë "Ndryshimi," vijnë prej Modulit 1 të programit të GIZ-it. I tërë materiali i rifreskuar është hartuar për t'i marrë parasysh pritjet që dalin prej udhëzimit administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) me titull "Standardet për praktikën profesionale për drejtorë të shkollave." Këto standarde janë hartuar me përkrahje teknike të Programit për Arsim Themelor të USAID-it. Ky seminar është pjesë e Programit të rishikuar të trajnimit për drejtorë të shkollave. Seminarët e rifreskuara do t'i trajtojnë këto standarde si nga ana e përmbajtjes ashtu edhe nga zbatimi i tyre praktik.

Seminari u bazua në Programin e GIZ-it për trajnimin e drejtorëve të shkollave (i akredituar nga MASHT-i më 10.02.2012 me numër zyrtar 45/12 në protokollin e certifikimit të zyrës për akreditim), si dhe u rishikua nga Selim Mehmeti, Osman Buleshkaj dhe David Lynn në emër të GIZ IS në kuadër të projektit të financuar nga EU "Trajnimi i mësimdhënësve dhe ngritja e kapaciteteve të komunave dhe drejtorëve të shkollave" në bashkëpunim me ekspertët e Programit për Arsim Themelor të USAID-it. Këta ekspertë e përzgjedhën, integruan, rishikuan dhe redaktuan materialin e trajnimit për menaxhimin dhe administrimin e shkollës nga GIZ, MASHT, projekti i BE-së Qasja Ndërsektorale në Arsim (SWAp), Programi për Arsim Themelor i USAID-it dhe Programi për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë (KEDP) me qëllim që të krijohej një material gjithëpërfshirës, i rishikuar dhe i përmirësuar. Programi i rishikuar është akredituar nga MASHT me 29.08.2012 me numër zyrtar 60/12 në protokollin e certifikimit të zyrës për akreditim.

REDAKTIMI GRAFIK

indesign

BOTIMI I PARË

Mars, 2013

PËRMBAJTJA

Shkurtesat	6
Seminari i Një - Pjesa e parë - Edukimi Cilësor pasqyra e përgjithshme	7
1. Hyrje	7
1.1. Qëllimi i Seminarit.....	8
1.1. Performanca e pritur	8
2. Ndryshimi	8
2.1. Të kuptuarit e ndryshimit	11
3. E drejta për Arsim	15
Katër Karakteristikat Thelbësore të Arsimit.....	15
4. Korniza Ndërkombëtare për edukim cilësor	16
4.1. Qëllimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit /QZhM.....	16
4.2. Nisma “Arsimi për të gjithë”/ApGj	17
4.3. Arsimi në BE.....	17
4.3.1. Objektivat e BE-së për Arsim dhe Trajnim - (Standardet për vitin 2020).....	17
4.4. Korniza e Treguesve të Arsimit në Kosovë.....	18
5. Nga edukimi sasior në edukimin cilësor	18
6. Edukimi cilësor dhe Zhvillimi Ekonomik	20
7. Edukimi cilësor: Përkufizimi dhe faktorët përcaktues	22
7.1. Masat e Sistemit të Cilësisë.....	23
8. Të Kuptuarit e Arsimit Cilësor	25
8.1. Roli i menaxhmentit të shkollës në edukimin cilësor.....	28
8.2. Standardet për Menaxhim dhe Udhëheqje të Cilësisë në Shkolla	29
8.3. Fushat e Cilësisë për Zhvillimin e Shkollës	30
Fjalorthi	31
Referencat	32
Seminari Një - Pjesa e dytë - Edukimi Cilësor dhe shkollat e mira	33

SHKURTESAT

UA - Udhëzimi Administrativ

KDF - Konventa për të Drejtat e Fëmijës

KBK - Kurrikula Bërthamë e Kosovës

KKK - Korniza e Kurrikulës së Kosovës

MASHT - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Seminari Një – Pjesa e parë - Edukimi Cilësor – pasqyra e përgjithshme

1. Hyrje

Çdokush ka të drejtë në arsim, siç garantohet me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNj)¹ që u miratua në vitin 1948. Konventa e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara (KDNj)², që u miratua në vitin 1989 si konkretizim i Të Drejtave Universale të Njeriut për fëmijë, e bën të veçantë të drejtën në arsim. KDF është afër ratifikimit universal dhe kështu është bërë traktati më i miratuar ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Sipas Nenit 22³ të Kushtetutës së Kosovës, DUDNj dhe KDF kanë zbatim të drejtpërdrejtë për të drejtat e njeriut në Kosovë. Ligji i ri për arsim para-universitar⁴ në mënyrë të veçantë deklaroi në Nenin 3.1.: “Asnjë personi nuk i mohohet e drejta në arsim.”

“Të gjithë nxënësit kanë të drejtë në arsim” – çka do të thotë kjo për Kosovën në kontekstin aktual të saj? A u mohohet disa fëmijëve kjo e drejtë, nga kush dhe si?

Arsimi shihet si faktor kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve njerëzore, mirëqenies ekonomike, krijimit të paqes dhe sigurisë, zhvillimit të vlerave universale dhe përmirësimit të cilësisë së jetës në nivelin individual, familjar, shoqëror e global. Kosova e njëj këtë të drejtë dhe rëndësinë e saj për vendin; prandaj, ajo është e përkushtuar për përmirësimin e situatës aktuale në arsim duke ofruar mundësi më të mëdha të pjesëmarrjes në arsim për të gjithë fëmijët. Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, zt. Ramë Buja ka theksuar se prioritetet për MASHT në vitet që vijnë janë “cilësia dhe gjithëpërfshirja”.

Sfida është se si të rritet cilësia dhe përfshirja në sistemin arsimor të Kosovës

Ky program trajnuet për Drejtorë Shkollash është dizajnuar të zhvillojë kapacitetet e drejtorëve të shkollave për të plotësuar pritjet për performancë profesionale të përfshira në Standardet e Praktikës Profesionale për Drejtorët e Shkollave (UA 04/2012; [02-05-2012]) dhe është moment i rëndësishëm veprimi për ngritjen e cilësisë në shkollat e Kosovës.

Sistemi i arsimit në Kosovë është në vllugun e ndryshimit. Janë përgatitur dhe po përgatiten ligje të reja, kurrikula të reja, pritje të reja më të larta për performancën shkollë dhe për praktikën profesionale të mësimit dhe drejtorëve të shkollave. Seminari adreson së pari fenomenin e ndryshimit dhe parimet e ndërlidhura me praktikën e drejtorëve të shkollave. Pastaj seminari e kthen vëmendjen tek çështja më e madhe: Ç’është edukimi cilësor? Si përkufizohet cilësia? Çfarë i duhet Kosovës që sistemi arsimor i saj t’i plotësojë standardet europiane? Seminari i dytë kalon nga ‘pasqyra e madhe’ e cilësisë tek çështjet kritike të ndikimit; aty ku cilësia është më e rëndësishme – në shkolla.

1 Shiko shtojcën: Shtojca 1: Deklarata e të Drejtave të Njeriut;

2 Shiko shtojcën: Shtojca 2: Konventa e të Drejtave të Fëmijës

3 Neni 22 i Kushtetutës së Kosovës [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

(3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;

(4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;

(5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;

(6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;

(7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;

(8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjërëzore dhe Poshtëruese.

4 Shiko shtojcën: Shtojca 5; Ligji për Arsimin Para-universitar në Republikën e Kosovës.

1.1. Qëllimi i Seminarit

Qëllimi i seminarit *Ndryshimi dhe E Drejta për Arsim – Edukimi cilësor* është që t'u ofrojë pjesëmarrësve një pasqyrë të burimit të pritjeve për arsim që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në arsimin dhe shkollat e Kosovës. Në thelb, pritjet janë që të gjithë nxënësit do të marrin arsim cilësor pavarësisht prej racës, gjinisë, aftësive fizike, aftësive mendore, përkatësisë etnike apo statusit shoqëror. **Drejtori i shkollës ka rol qendror në përmbushjen e këtyre pritjeve.** Pozita e tij/saj është si motor i një makine të madhe e të komplikuar. Nëse motori ndalon asgjë tjetër nuk punon, por nëse motori është i fuqishëm, e tërë makina ka shumë fuqi dhe mund të bëjë shumë gjëra. Motori ofron energji për makinën (apo sistemin) për të ndryshuar.

1.2. Performanca e pritur

Pjesëmarrësit në trajnimin për menaxhimin në arsim pritet të arrijnë rezultatet në vijim sa i përket 'njohurive.' Pjesëmarrësit do të fillojnë të zhvillojnë 'shkathtësinë' në:

Të:

1. Zhvillojnë të kuptuarit bazik për natyrën e ndryshimit,
2. Fitojnë dije që do të lehtësojë ngritjen e praktikave të udhëheqësisë,
3. Kuptojnë thelbin se çka është edukimi cilësor,
4. Kuptojnë dhe dinë rolin e rëndësishëm të drejtorëve të shkollave.
5. Identifikojnë sfidat e sigurimit të arsimit të cilësisë së lartë për të gjithë fëmijët në Kosovë,
6. Kuptojnë rolin qendror të mësimdhënies dhe nxënies,
7. Njoftohen me rolin udhëheqës të menaxhimit arsimor për edukim cilësor në shkollë,
8. Fillojnë të identifikojnë dhe kuptojnë sfidat specifike në shkollën e tyre.
9. Udhëheqjen e procesit të kërkimeve duke respektuar ndryshimet e obligueshme.

2. Ndryshimi

Këto që po ndodhin në arsimin në Kosovë janë ndryshime të mëdha. Ato duhet të realizohen në praktikë gjatë disa viteve të ardhshme nën udhëheqjen e drejtorëve të shkollave dhe të tjerëve dhe me përkushtimin e mësimdhënësve për të përmirësuar mësimdhënien dhe nxënien për nxënësit.

Çfarë po ndryshon?	Temat e ndërlidhura trajnuese
Standardet e reja të Praktikës Profesionale për Drejtorët e Shkollave që nënkupton: <i>Përgjegjësi të reja duke respektuar autonominë e shkollave dhe autoritetin e drejtorëve të shkollave</i>	<i>Udhëheqja, menaxhmenti, komunikimi, marrëdhëniet, vendim-marrja, bashkëpunimi, menxhimi i personelit dhe vlerësimi, dhe standardet e etikës</i>
Kurrikula	<i>Zbatimi i kurrikulës</i>
	<i>Trajnimi i Mësimdhënësve (aftësimi profesional)</i>
	<i>Ndryshimi në praktikat e mësimdhënies</i>
Vlerësimi i mësimnxënies dhe vlerësimi për mësimnxënie	<i>4 lloje të vlerësimit</i>

Çfarë po ndryshon?	Temat e ndërlidhura trajnuese
Përfshirja	<i>Të kuptuarit e asaj se çka është arsimi gjithëpërfshirës, zbulimi i qasjeve të ndryshme për përfshirjen, dhe disa strategji dhe aktivitete për praktikën shkollore</i>
Teknologjia	<i>Teknologjia si mjet për mësimdhënie</i>
	<i>Teknologjia si mjet për menaxhim</i>
	<i>Teknologjia si mjet për komunikim</i>
Vlerësimi organizativ	<i>Vlerësimi i shkollave</i>
	<i>Planifikimi për zhvillimin e shkollës</i>
Organizimet e brendshme shkollore	<i>Bordi udhëheqës i shkollës</i>
	<i>Këshilli i nxënësve</i>
	<i>Këshilli i prindërve</i>

Nga të gjitha këto ndryshime, më të rëndësishmet janë Korniza e Kurrikulës së Kosovës (KKK) dhe Kurrikula Bërthamë e Kosovës dhe të gjitha ndryshimet lëndore që dalin nga këto politika.

Ato janë menduar për të ngritur cilësinë e të diplomuarve nga shkollat në Kosovë; që t'i sjellin ata më afër standardeve europiane. Pasojat e këtyre pritjeve të larta për mësimnxënie kërkojnë që mësimdhënësit duhet të ndryshojnë mënyrën se si japin mësim në mënyrë që nxënësit të zhvillojnë kompetencat që priten prej tyre. Drejtorët e shkollave duhet ta udhëheqin këtë proces. Kjo është sfiduese, e rëndësishme dhe e arritshme. Ndryshimi është test për disa arsye. Mësimdhënësit dhe drejtorët jo vetëm që duhet të ndryshojnë praktikën e tyre profesionale, por edhe nxënësit, prindërit dhe komuniteti duhet ta kuptojnë çfarë po ndryshon dhe pse e poashtu edhe si do të përfitojnë nxënësit dhe komuniteti. Pyetja kryesore, në të gjitha nivelet, është, "Cili është përfitimi im nga kjo?"

Deri tani, udhëheqja e këtyre llojeve të ndryshimit nuk ka qenë asnjëherë përgjegjësi e drejtorëve të shkollave në Kosovë. Nga drejtorët nuk pritet të bëhen ekspert në çdo fushë të kurrikulës; ata do të bëhen ekspertë në zhvillimin e shkollës dhe mësimdhënësve dhe në zbatim. Rrjedhimisht, drejtorët duhet ta dinë dhe kuptojnë procesin e ndryshimit dhe tranzicionin që ndodh brenda tij.

Ndryshimi	Tranzicioni
<i>Puna e parë e menaxhimit të ndryshimit është të kuptojë destinacionin. Ku jemi duke shkuar dhe pse?</i>	<i>Puna e parë e tranzicionit është të Ndhimojë njerëzit ta lënë zonën e tyre të rehatisë! S'mundemi dhe nuk duhet të bëjmë të njëjtën gjë më.</i>
Detyra <i>Shqetësimi për prodhim Si ta menaxhojë rënien?</i>	Procesi <i>Shqetësimi për njerëzit Si t'i ndihmojë 'njerëzit e mi' që të rrezikojnë të ndryshojnë pa e humbur besimin e tyre profesional?</i>

Aktiviteti #1: (Pjesëmarrësit do të marrin një kopje të përmbledhjes së KKK-së.)

Duke shqyrtuar KKK-në:

1. Përshkruani mjedisin e sigurtë dhe miqësor për nxënësin. Si mund ta dalloni se keni një të tillë në shkollën tuaj?

2. Çka nënkupton për shkollën tuaj zbatimi i parimeve të arsimit gjithëpërfshirës duke marrë parasysh dhe adresuar nevojat, interesat dhe aftësitë e ndryshme të nxënësve? Çfarë do të ndryshojë duke e bërë këtë?
3. Cilat janë implikimet për mësimdhënien dhe nxënien me nxënësin në qendër për mësimdhënësit e mi? Cilat janë implikimet e këtyre zhvillimeve për shkollën time?
4. Dhe, më e rëndësishmja,
5. Çfarë duhet të mësojë unë në mënyrë që ta udhëheq shkollën gjatë këtij ndryshimi (p.sh. A e di çka është gjithëpërfshirja? A e kuptoj nxënien? A e kuptoj mësimdhënien me nxënësin në qendër? A di si t'i bind mësimdhënësit të ndryshojnë mënyrën si japin mësim ata?

Michael Fullan ka thënë, "Ajo që ka më së shumti rëndësi nuk mund të bëhet e obligueshme." Me fjalë tjera ju nuk mundeni vetëm t'i urdhëroni njerëzit që të ndryshojnë. Pse? Dhe, çka do të thotë kjo për praktikën tuaj si drejtor shkolle? Cila është pjesa e mësimdhënies dhe mësimnxënies që e bën ndryshimin aq sfidues?

Ndryshimi në mësimdhënie **nuk** ndodh sipas urdhërit; ai ndodh përmes procesit të mësimdhënies dhe nxënies dhe kërkon kureshtje, përkushtim dhe këmbëngulje për t'u arritur. Si do t'i zhvilloni këto cilësi në shkollën e tuaj? Shqyrtoni këto mendime.

Marchita Stanton, një hulumtuese e interesuar në **organizata dhe ndryshim**, sugjeron se në mënyrë që planet e veprimit të lehtësojnë ndryshimin ato duhet të përmbajnë cilësitë dhe praktikën në vijim:

Kreativiteti – gjetja e mënyrave për të bërë gjërat

Të dëgjuarit – t'u komunikohet të tjerëve se mendimet e tyre vlerësohen

Orientimi i ekipit – të kërkohe mënyra për bashkëpunim

Mbikëqyrja – (mund të jetë cilësia më e fuqishme për të ndikuar ndryshimin)

Llogaridhënia – marrja e përgjegjësisë për suksesin e ndryshimit, të modelohet sjellja e dëshiruar

Vlerësueshmëria – njihen dhe shpërblehen përpjekjet për të bërë ndryshimin të suksesshëm

Si udhëheqëse e ekipit Stanton do të pyeste, "Si e zhvilloni aftësinë për ndryshim brenda shkollës suaj?" Si drejtor, si do të krijoni:

Përkushtimin – Si do t'i ndihmoni mësimdhënësit tuaj që të përjetojnë punën e tyre si kuptimplote? Si i ndihmoni ata që të kenë ndjenjën se ku po shkojnë dhe në çka po përfshihen?

Kontrollin – Si i bëni mësimdhënësit të ndihen të lirë të ndërmarrin veprime dhe të bëjnë atë që duhet bërë? Si i bëni të ndihen se kanë kontroll mbi punën e tyre?

Sfidën – Si i angazhoni mësimdhënësit që të jenë të hapur për nxënien? A është njësi e biznesit e hapur për nxënien e mësimdhënësit? A shihet ndryshimi si mundësi për të zhvilluar shkathhtësitë dhe për të mësuar?

Lidhjen – Si siguron që mësimdhënësit e dinë se ata mund të llogarisin tek të tjerët për ndihmë dhe përkrahje?

Aktiviteti #2

Shqyrtoni dhe diskutoni këto pyetje:

1. Çfarë duhet të bëni që mësimdhënësit të zhvillojnë aftësitë e përkushtimit, kontrollit, sfidës, dhe lidhjes në shkollën e tuaj?
2. Çfarë duhet të mësoni me qëllim që të zhvilloni këto aftësi tek stafi juaj?
3. A jeni të gatshëm të pranoni se ju, si drejtor shkolle, nuk dini apo nuk kuptoni diçka të rëndësishme (siç është KKK-ja)? Si mund të ju ndihmojmë në këtë aspekt?

2.1. Të kuptuarit e ndryshimit

"Ndryshimi është i vështirë sepse njerëzit e mbivlerësojnë vlerën e asaj që ata kanë—dhe e nënvlerësojnë vlerën e asaj që do të fitojnë nëse heqin dorë prej asaj që e kanë."


- James Belasco dhe Ralph Stayer *Ikja e Buallit* (1994)

Është lehtë të bisedohet për ndryshimin; bërja e tij është çështje tjetër. Pse? Sepse, ndryshimi themelor sfidon besimet tona lidhur me atë që e "dimë" dhe "bëjmë."

Ndryshimi nuk ndodh në mënyrë lineare, megjithatë ai përmban fazat ndërvepruese në vijim:



Proceset ndërvepruese në mesin e ndryshimeve në njohuritë e mësimitdhënësve, praktika dhe rezultatet mësimore të nxënësve përshkruhen në mënyrë grafike në faqen në vijim.



Ky proces do të ndodh me zbatimin e KKK-së së re. Këto janë implikimet e saj:

1. Pritjet se si punojnë mësime dhënësit me fëmijët për të nxitur nxënien ndryshojnë plotësisht. Mësimdhënia nuk është më vetëm të treguarit; ajo është edhe proces i të nxënies.
2. Teksti nuk është më kurrikulë.
3. Vlerësimi i mësimnxënies dhe vlerësimi për mësimnxënien është më i sofistikuar, 'më i besueshëm' dhe më i rëndësishëm për nxëniesit se sa në praktikën aktuale.
4. Rezultatet mësimore bazohen në kompetenca të vëzhgueshme/matshme.

Argumenti kryesor është se ndryshimi nuk ndodh derisa praktikatat e reja të bëhen pjesë e asaj që mësime dhënësit besojnë se është në interesin më të mirë të nxëniesve por edhe në interesin e tyre si mësime dhënësit. Praktikatat tona udhëhiqen nga besimet.

Prandaj, kjo në vijim është ajo që duhet të dini:

- KKK-ja e re i sfidon besimet e mësime dhënësit lidhur me rolin e tyre, ajo se çka është praktikë e mirë profesionale dhe çka është në të mirë të nxëniesve.
- Për shumë mësime dhënësit, kjo sfidë është jashtëzakonisht personale.
- Besimet nuk bazohen në dëshmi empirike. Mësime dhënësit duhet të shohin (përfytyrojnë) përfitimet e ndryshimit para se të ndërmarrin rrezikun e ndryshimit.
- Performanca profesionale dhe ajo e nxëniesve bien para se të përmirësohen. Kjo e bën më të vështirë për mësime dhënësit të binden 'që të qëndrojnë në rrugën e njëjtë' dhe të vazhdojnë të përpiqen dhe zhvillojnë praktikatat e reja.

Fjalja e fundit është ajo që e bën ndryshimin aq të vështirë. Mos-arritja e rezultateve të menjëhershme i shtyn njerëzit që të dorëzohen; veçanërisht nëse ata nuk ndihen të sigurtë të arrijnë rezultate më të këqija para se të arrijnë rezultate më të mira. Ky fenomen quhet "rënia e ndryshimit" apo thjeshtë 'rënia'. Puna juaj është që t'i ndihmoni mësime dhënësit të kalojnë nëpër këtë përvojë!

Aktiviteti #3

Shqyrtoni përgjigjet e secilës nga pyetjet e mëposhtme dhe pastaj diskutoni përgjigjet tuaja me grupin tuaj. Kur të keni përfunduar përgjigjet në pyetje, në shënime tuaja, shënoni se çfarë pikëpamjesh të reja po fitoni nga kjo temë dhe çfarë pikëpamjesh të reja po fitoni nga grupi juaj.

1. Çfarë besoni se është e rëndësishme për mësime dhënësit dhe nxënien? A është kjo e ndryshme nga ajo që pritet në KKK? Si dhe çka duhet të ndryshoni?
2. KKK-ja parasheh ndryshime në pritjen e rezultateve të të nxëniesit në aspektin e asaj se çka dhe si pritet të mësojnë nxëniesit. A do t'i sfidojnë besimet e mësime dhënësit ndryshimet në pritjet për rezultatet e nxëniesve në aspektin e asaj se çka dhe si duhet të mësojnë nxëniesit?
3. Çfarë shihni si sfidë kryesore për të ndikuar te mësime dhënësit që të zhvillojnë praktikat dhe besime të reja për mësime dhënësit dhe nxënien?
4. Çfarë rreziqesh tjera parashikoni gjatë ndërmarrjes së ndryshimeve të pritura në KKK-në e re? Si mendoni të zbatoni këtë pjesë në shkollën tuaj?

Ndryshimi është një rrugëtim nëpër ujëra të pakalueshme: dihet vetëm destinacioni i tij!

Në udhëheqjen e shkollës përemri që duhet të jetë "në fuqi" është 'ne'. Por, sikurse për secilin mësime dhënësit në shkollën tuaj, ka çështje të rëndësishme me implikime për ty si individ dhe si drejtor. Ato janë:

- Unë duhet të besoj se unë mund të bëjë dallimin dhe të ndihmoj këtë shkollë që t'iu shërbejë më mirë fëmijëve (më efektivisht)
- Unë duhet të besoj se ne, si staf, mund t'iu shërbejmë fëmijëve në mënyrë më efektive.
- Unë duhet të jem i ngazëllyer për mundësitë dhe shancet për çka 'ne' mund të bëjmë për shkollën tonë, për nxënësit tanë në mënyrë që t'i udhëheqin të tjerët.
- Unë duhet të ftoj të tjerët të udhëheqin me mua që të përcaktojmë rrugëtimin e ndryshimit.
- Unë duhet të gjejë masa të besueshme që do të tregojnë se ku jemi ne në rrugëtimin tonë të ndryshimit.
- Cilat janë implikimet tjera për mua në udhëheqjen dhe menaxhimin e ndryshimit në shkollën time?
- Mënyra se si i përmbushni përgjegjësitë si drejtor ka shumë rëndësi nëse do ta arrini apo jo destinacionin tuaj. Daniel Goleman autori i famshëm i librit "Intelegjenca emocionale" ka identifikuar gjashtë lloje të udhëheqjes në sjellje në vijim: katër prej të cilave funksionojnë, dy të tjera nuk funksionojnë? Cilat stile i përdorni ju?

Praktikat e Golemanit për udhëheqjen e ndryshimit

1. Detyruese—udhëheqësi kërkon pëlqim ("Bëj çfarë të them unë.")
2. Autoritative—udhëheqësi mobilizon njerëzit drejt një vizioni. ("Ejani me mua.")
3. Ndërlidhëse—udhëheqësi krijon harmoni dhe ndërton lidhje emocionale ("Njerëzit janë në rend të parë.")
4. Demokratike—udhëheqësi krijon konsensus me pjesëmarrje. ("Çfarë mendoni ju?")
5. Vendosje e dinamikës—udhëheqësi vendos standarte të larta për performancën ("Bëj çka bëj unë, tani.")
6. Mentorim—udhëheqësi përgatit njerëz për të ardhmen. ("Provoje këtë.")

Prandaj, cila prej tyre funksionon?

Dy prej gjashtë stileve ndikojnë negativisht në klimën e shkollës dhe në këtë mënyrë edhe në performancë. **Këto ishin** stili detyrues (njerëzit nuk durojnë dhe rezistojnë) dhe stili i vendosjes së dinamikës (njerëzit ngarkohen tepër dhe shpenzohen). Të gjithë katër stilet tjera kanë ndikim të konsiderueshëm pozitiv në klimë dhe performancë.⁵

Vetëdija për atë që e dini, çka do të bëni? Më poshtë është një detyrë që mund ta zgjedhni ta realizoni pas këtij seminari:

Filloni të përgatisni një plan personal për zbatim të KKK-së në shkollën tuaj.

- Me kënd do të komunikoni, si?
- Si do të identifikoni atë që duhet ta mësoni?
- Kush mendoni se do t'iu ndihmojë ju dhe stafit tuaj për zbatimin e KKK-së së re?
- Cila mendoni se është koha e arsyeshme për zbatim?
- Si do ta dini nëse shkolla juaj është duke pasur sukses në zbatimin e KKK-së?

Të gjitha këto ndryshime që po ndodhin në Kosovë synojnë të përmirësojnë cilësinë në arsim dhe ngritjen e saj në nivelin e standardeve europiane. Kjo e ngrit pyetjen, çka është edukimi cilësor dhe pse fëmijët tonë⁶ kanë të drejtë në të?

⁵ Michael Fullan, Udhëheqja e kulturës së ndryshimit; f. 5/15

⁶ Fëmijë është secili person i moshës prej lindjes deri në 18 vjeç.

Siç u tha më parë:

Sfida është si të ngritet cilësia dhe gjithëpërfshirja

Derisa pjesëmarrja më e lartë në shkollë është e mirë; kjo nuk është domosdoshmërisht pasqyrim i cilësisë. Rrjedhimisht, duhet t'i kushtohet vëmendje arsimit cilësor për fëmijët në shkollat tona për të avancuar zhvillimin e tyre të përgjithshëm. Ky është momenti kur shkollat e Kosovës do të jenë më të suksesshmet.

Seksioni *Edukimi cilësor – pasqyra e përgjithshme* ofron informata të përgjithshme lidhur me arsimin cilësor në raport me Kosovën. Ai identifikon faktorë të ndryshëm që përcaktojnë cilësinë dhe rolin e veçantë që mësimdhënësit dhe menaxhmenti arsimor kanë në arritjen e saj. Për Kosovën sfida është e dyfishtë: të rritet cilësia e arsimit në kontekstin e decentralizimit të vazhdueshëm në një shtet shumë të ri, vetëm pak vite pas pavarësisë. Për të ndryshuar kulturën e arsimit përmes komandimit – kontrollit të qasjes integruese prej lartë-poshtë dhe prej poshtë-lartë është sfida e dytë. Rritja e autonomisë së shkollës është mundësi e madhe për cilësinë e përmirësuar arsimore nëse autonomia shpie në kalimin e vendim-marrjes dhe financimit tek shkollat, më shumë pjesëmarrje të komunitetit, sinqeritet dhe përkrahje aktive për mësimnxënie. E tërë kjo është ndryshim.

Decentralizimi është proces – ai realizohet në hapa të shumtë; ndryshimet ndodhin gradualisht. Por është e qartë se ai sjell dallime të mëdha në rolin e drejtorëve të shkollave: tani ata duhet të bëhen udhëheqës të procesit të përmirësimit të cilësisë ku, historikisht, ata kanë qenë vetëm menaxherë të administratës së shkollës. Përgjegjësitë aktuale për administrim të përfshira në Standardet e Praktikës Profesionale për Drejtorë të Shkollave në Kosovë, vlejné edhe për udhëheqje efektive EDHE për menaxhim.

Rolet e ndryshme të drejtorit të shkollës:

Me autonominë në rritje drejtorët e shkollave duhet të bëhen vizionarë, planifikuesë arsimorë, nismëtarë të zhvillimit të shkollës, komunikuesë për të siguruar pjesëmarrje të gjerë të komunitetit, përkrahës për cilësinë në mësimdhënie e mësimnxënie, moderator për akterët kryesor të shkollës, menaxherë për resurset teknike e financiare, udhëheqës për stafin dhe nxënësit e tyre të cilët marrin vendime të informuara në bazë të të dhënave dhe drejtojnë shkollë në mënyrë efektive e strategjike në një kontekst konkurrues në rritje me qëllim që të arrihen rezultatet më të mira të mundshme për nxënësit e tyre me resurset në dispozicion.

MASHT ka zhvilluar politikat arsimore efektive dhe ka vënë një kornizë të mirë të politikave për cilësinë arsimore. Varet nga personeli i shkollës që ta bëjë politikën realitet.

Në ligjet dhe politikat më të rëndësishme përfshihen miratimi i Ligjit të ri për Arsimin Para-universitar, Plani Strategjik për Arsim në Kosovë (PSAK)⁷, Korniza e Kurrikulës së Kosovës (KKK)⁸ dhe Plani Kombëtar i Veprimit kundër Iqjes nga Orët e Mësimin në Shkollë. PSAK, KKK dhe zbatimi i liçencimit të mësimdhënësve (UA 5/2010) kanë implikime të thella për shkollat. Kjo kornizë dhe përpjekjet që vazhdimisht të përfshihen dhe të informohen të gjithë akterët relevant e poashtu edhe masat si bërja publike e rezultateve të performancës në arsim, mund të shërbejnë si pikënisje për reflektim mbi kontekstin e Kosovës – në nivelin qendror, komunal dhe shkollor. Avancimi i cilësisë në arsim është përgjegjësi e përbashkët e të gjitha palëve të interesit në fushën e arsimit në të gjitha nivelet. Ky është ndryshimi; kjo është ajo që duhet ta mësoni për të udhëhequr.

⁷ Shiko shtojcën: Shtojca 6: Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë 2011-2016

⁸ 6 Shiko shtojcën: Shtojca 9: Korniza e Kurrikulës së Kosovës (KKK)

3. E drejta për Arsim

E drejta për arsim është ripohuar disa herë që kur është shpallur në vitin 1948 përmes Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ)⁹ dhe më vonë e konkretizuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF) në nenet 28 dhe 29. Këto traktate thonë se, të paktën, arsimi fillor duhet të jetë falas dhe i detyrueshëm ndërsa arsimi i mesëm dhe i lartë duhet të jetë i qasshëm në mënyrë të vazhdueshme për të gjithë, edhe pse jo domosdoshmërisht falas. Neni 28 i KDF e përkufizon arsimin si të *drejtë* dhe rekomandon hapat si të realizohet kjo e drejtë “në mënyrë progresive dhe në bazë të mundësive të barabarta”.

Këta hapa janë:

- Arsimi fillor duhet të jetë i detyrueshëm dhe në dispozicion falas për të gjithë. Arsimi i mesëm duhet të jetë në dispozicion dhe i qasshëm për secilin fëmijë, me ndihmë financiare nëse është e nevojshme.
- Shteteve u kërkohet që të nxisin vijueshmërinë dhe zvogëlojnë shkallën e braktisjes.
- Atyre poashtu u kërkohet të ndërmarin masa për të siguruar se disiplina në shkollë administrohet në mënyrë konsistente me dinjitetin njerëzor të fëmijës.
- Atyre poashtu u kërkohet të promovojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit.

Neni 29 ka të bëjë me qëllimin e arsimit shkollor, i cili duhet të

- Ndhimjë fëmijën në zhvillimin e “personalitetit, talenteve dhe aftësive fizike e mendore në potencialin e plotë” të tij/saj.
- Zhvillojnë respektin për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.

Shkolla poashtu duhet të ndihmojë fëmijën që të përgatitet për “jetë me përgjegjësi në një shoqëri të lirë, në frymën e të kuptuarit, paqes, tolerancës, barazisë së gjinive, dhe miqësisë mes të gjithë njerëzve, grupeve etnike, kombëtare dhe fetare dhe personave më origjinë autoktone”. Në fund, neni thekson rëndësinë e shkollës në zhvillimin e respektit për mjedisin natyror.

Katër Karakteristikat Thelbësore të Arsimit

Edhe pse forma e arsimit varet në kushtet e veçanta të një shteti, arsimi duhet të përfshijë katër karakteristika thelbësore, sipas Komentit të Përgjithshëm Nr. 13 nga Komisioni për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore i Kombeve të Bashkuara (KDEShK 1999):

Disponueshmëria në mes tjerash i referohet ekzistencës së ndërtesave shkollore dhe programeve funksionale në sasi të mjaftueshme. Më tutje ajo iu referohet aspekteve si disponueshmëria e mësimdhënësve të trajnuar, materiali mësimor, uji i pijëshëm dhe objekte të ndara sanitare për vajza dhe djem.

Qasshmëria kërkon mundësi jo-diskriminuese dhe të barabarta për arsim. Kjo karakteristikë ka një dimension fizik sa i përket rrugës për në shkollë dhe një dimension ekonomik sa i përket tarifave shkollore.

Pranueshmëria ndërlidhet me **cilësinë e arsimit**, që nënkupton cilësinë e metodave të mësimdhënies dhe kurrikula. Këto duhet të jenë të përshtatshme në aspektin kulturor dhe të ndërlidhura me nxënësit.

Përshtatshmëria kërkon që arsimi dhe shkollimi të jenë fleksibil dhe në pajtueshmëri me gjendjen dhe nevojat e nxënësve. E drejta për arsim është vendimtare pasi që ajo nuk është vetëm e drejtë në vete, por poashtu është edhe faktor lehtësues për një numër të drejtash tjera.

⁹ E drejta për arsim garantohet me Nenin 26 të DUDNJ:

Është instrument i rëndësishëm për të përkrahur njohuritë për dhe realizimin e të drejtave tjera të njeriut: një person i arsimuar është në pozitë më të mirë që të kërkojë të drejtat e tij/saj, p.sh. të drejtën për qasje në shëndetësi, të drejtat politike si qytetarë, apo e drejta për punë dhe zgjedhje të lirë të punësimit për të kërkuar dhe për t'i përdorur ato. Prandaj edukimi cilësor shikohet si “hapës i dyerëve” për të drejtat tjera të njeriut dhe si mjet për të kundërshtuar diskriminimin.



Aktiviteti #4 – Ju lutem reflektoni mbi pyetjet në vijim:

1. Pse është aq e rëndësishme E Drejta për Arsimit, për Kosovën, veçanërisht në shekullin 21?
2. Në aspektin e Katër A-ve (faqja e mësipërme), cilat prej tyre janë përmbushur në shkollën tuaj dhe cilat paraqesin sfidë?
3. Në ndërlidhje me Të Drejtën për Arsimit, më cilat probleme përballeni që janë më të rëndësishme tani se sa kanë qenë në të kaluarën?

4. Korniza Ndërkombëtare për edukim cilësor

Arsimi si “çelës për zhvillim” ka fituar gjithnjë e më shumë rëndësi edhe në deklaratat ndërkombëtare dhe nismat mbarëbotërore për zhvillim siç janë Qëllimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit (QZhM) apo Nisma “Arsimi për të Gjithë” (ApGj).

4.1. Qëllimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit /QZhM

Qëllimet relevante Zhvillimore të Mijëvjeçarit (QZhM)¹⁰ mbi arsimin fokusohen në arritshmërinë e arsimit fillor universal për të gjithë fëmijët deri në vitin 2015 dhe janë shprehur në qëllimet 2 dhe 3:

Qëllimi 2: Arritja e arsimit fillor universal: Deri në vitin 2015, të gjithë fëmijët mund të përfundojnë kohëzgjatjen e plotë të shkollimit fillor, vajzat dhe djemtë.

Qëllimi 3: Barazia gjinore: Të eliminohet pabarazia gjinore në arsimin fillor dhe të mesëm, e preferueshme deri në vitin 2005, dhe në të gjitha nivelet e arsimit jo më vonë se deri në vitin 2015.

¹⁰ Shiko shtojcën: Shtojca 3 Qëllimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit

4.2. Nisma “Arsimi për të gjithë”/ApGj

Si rezultat i Konferencës Botërore mbi Arsimin për të Gjithë të Kombeve të Bashkuara e mbajtur në vitin 1990 në Jomtien, në Tajlandë, u themelua nisma mbarëbotërore “**Arsimi për të Gjithë /ApGj**”. Që atëherë, 189 shtete kanë nënshkruar Nismën dhe janë pajtuar me gjashtë qëllimet:

Qëllimi 1: Zgjerimi dhe përmirësimi i kujdesit dhe arsimit gjithëpërfshirës për edukum të hershëm, veçanërisht për fëmijët më të pafavorizuar dhe më të prekshëm.

Qëllimi 2: Sigurimi që deri me 2015 të gjithë fëmijët, veçanërisht vajzat, fëmijët në rrethana të vështira dhe ata që u përkasin minoriteteve etnike, kanë qasje dhe përfundojnë arsimin fillor falas dhe të detyrueshëm të cilësisë së mirë.

Qëllimi 3: Sigurimi që nevojat për mësimnxënie të të gjithë të rinjëve dhe të rriturve plotësohen përmes qasjes së paanshme në mësimnxënie adekuate dhe programe për shkathtësi jete.

Qëllimi 4: Arritja e përmirësimit prej 50 për qind në nivelet e shkrim-leximit të të rriturve deri në vitin 2015, veçanërisht për gratë, dhe qasja e paanshme në arsimin bazik dhe të vazhdueshëm për të gjithë të rriturit.

Qëllimi 5: Eliminimi e pabarazisë gjinore në arsimin fillor dhe të mesëm deri me 2005, dhe arritja e barazisë gjinore në arsim deri me 2015, me fokus për të siguruar qasjen dhe arritjen e plotë dhe të barabartë të vajzave në arsimin bazik të cilësisë së mirë.

Qëllimi 6: Përmirësimi i të gjitha aspekteve të cilësisë në arsim dhe sigurimit të përsosmërisë së të gjithëve ashtu që rezultatet mësimore të pranueshme dhe të matshme arrihen nga të gjithë, veçanërisht në shkrim-lexim, matematikë dhe shkathtësitë jetësore thelbësore.

4.3. Arsimi në BE

Në Traktatin e Romës të vitit 1957 aftësimi profesional u bë fushë e veprimit të komunitetit. Në vitin 1992, arsimi u njoh si fushë e kompetencave të Bashkimit Europian.

Traktati thotë: *“Komuniteti do të kontribuojë në zhvillimin e arsimit cilësor duke nxitur bashkëpunimin mes Shteteve Anëtare dhe, nëse është e nevojshme, duke përkrahur dhe plotësuar veprimin e tyre, duke respektuar tërësisht përgjegjësinë e Shteteve Anëtare për përmbajtjen e mësimdhënies dhe organizimin e sistemeve arsimore dhe diversitetin e tyre kulturor e gjuhësor.”*

Në fakt “Traktati i Lisbonës”, në fuqi që nga 1 dhjetori 2009, nuk i ka ndryshuar kërkesat për rolin e BE-së në arsim dhe trajnim¹¹.

Për të arritur këto synime, BE ka një program të madh për arsim me programet COMENIUS për shkollat, ERASMUS për arsimin e lartë, LEONARDO DA VINCI për shkollat profesionale dhe trajnime dhe GRUNDTVIG për arsimin e të rriturve.

4.3.1. Objektivat e BE-së për Arsim dhe Trajnim - (Standardet për vitin 2020)

Korniza e rifreskuar Strategjike për Bashkëpunim Europian në Arsim dhe Trajnim¹² (e njohur si ET 2020), e përgatitur nga Komisioni e Komuniteteve Europiane dhe e miratuar nga Këshilli i Ministrave të Arsimit, shërben si mekanizëm kryesor për të dhënë informata për porositë e politikave arsimore të nivelit të lartë në Strategjinë e Bashkimit Europian për Europën 2020 për të mobilizuar politikën në të gjitha sistemet për rritje të menqur, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse në aspektik shoqëror.

Shtetet Anëtare dhe Komisioni që punojnë në këtë drejtim përdorin tregues dhe standarde për të informuar dhe udhëhequr politikë-bërjen e bazuar në dëshmi dhe si mjet për të monitoruar

¹¹ Shiko shtojcën: Shtojca 4: Traktati i Lisbonës

¹² Objektivat e Trajnimit dhe Standardet e BE-së (krahasoni 2010-2020)», 2011

progresin, edhe në nivelet kombëtare edhe në atë të BE-së drejt objektivave strategjike të pranuar bashkërisht për arsim dhe trajnim.

Pesë standardet e përgjithshme të vendosura brenda këtij dokumenti, për arsim dhe trajnim janë siç vijon:

- Të paktën 95% e fëmijëve mes 4 vjeç dhe moshës për fillimin e arsimit të detyrueshëm fillor duhet të marrin pjesë në arsimin për edukim të hershëm;
- Numri i atyre që e lëshojnë arsimin dhe trajnimin herët duhet të jetë më pak se 10%;
- Numri i 15 vjeçarëve me arritshmëri të ulët në lexim, matematikë dhe shkenca duhet të jetë më i ulët se 15%;
- Numri i 30-34 vjeçarëve me arritje në arsimin terciar duhet të jetë të paktën 40%;
- Mesatarisht të paktën 15 % e të rriturve duhet të marrin pjesë në mësimin tërëjetësor.

Dy nga këto pesë standarde (reduktimi i numrit të nxënësve që e lënë shkollën herët; dhe rritja e pjesëmarrjes së të rinjve që kanë kualifikime të arsimit terciar) u është dhënë rëndësi e mëtejme pasi që janë zgjedhur si prioritete kryesore për Europën deri në vitin 2020 për zhvillimin ekonomik deri me 2020 pasi që përmes këtyre standardeve pasqyrohen lidhjet me arsim dhe tregun e punës dhe të cilat kanë rëndësi të madhe për punësueshmëri dhe vende pune.

4.4. Korniza e Treguesve të Arsimit në Kosovë

MASHT ka përcaktuar treguesit që janë relevant për Kosovën të cilët korrespondojnë me treguesit e përgjithshëm arsimor siç janë ata të Nismës së APGJ, dhe treguesit që ndërlidhen me “qasjen dhe pjesëmarrjen”, resurset financiare, efektivitetin e brendshëm dhe kushtet për mësimnxënie.¹³

Plani Strategjik për Arsim në Kosovë/PSAK poashtu përcakton një bashkësi të treguesve kryesor për të monitoruar planin e zbatimit¹⁴.

Treguesit tregojnë vlerën e lartë që i jipet trajnimit të drejtorëve të shkollave dhe komunave, dhe trajnimit të vazhdueshëm të mësimdhënësve. Tema e gjithëpërfshirjes poashtu është vlerësuar në PSAK nga tregues që ndërlidhen me numrin e fëmijëve të pafavorizuar që duhet t'i bashkangjiten dhe të mbesin në arsimin e detyrueshëm.

MASHT ka themeluar Zyrë të brendshme të Operacioneve dhe një Komision Drejtues për të monitoruar progresin dhe për të siguruar zbatimin e PSAK.

Sistemi i sapo themeluar i menaxhimit të informatave në arsim (SMIA) i ndihmon MASHT-it të tregojë të gjithë informatat dhe të dhënat e nevojshme për këtë detyrë.

5. Nga edukimi sasiar në edukimin cilësor

Fokusi në arsimim solli rritje të përpjekjeve mbarëbotërore për të përmirësuar arsimin për të gjithë fëmijët. Pasi që këto programe kombëtare dhe ndërkombëtare janë monitoruar vazhdimisht dhe vlerësuar rregullisht të kuptuarit tonë për arsimin u thellua dhe një gamë e gjerë e hulumtimeve të fundit na kanë ndihmuar të korigjojmë disa prej perceptimeve tona se si mund ta zhvillojmë arsimin.

Ka ekzistuar, dhe ende ekziston në disa shtete, supozimi themelor se arsimiti forcohet kur fëmijët kanë mundësi të qëndrojnë në shkollë më gjatë: kohëzgjatja e arsimit, sasia e arsimit është parë si faktor kryesor për arsim të mirë.

¹³ Shiko shtojcën: Shtojca 7: Korniza e Treguesëve Arsimorë

¹⁴ Shiko shtojcën: Edukimi cilësor, Shtojca 8: Korniza e Vlerësimit të Performancës (TRC)

Hulumtimet tani na tregojnë se koha është faktor me rëndësi, por më e rëndësishme është **ajo që faktikisht ndodh** gjatë asaj kohe: në disa shtete në botë fëmijët rrinë ulur në klasa për vite e vite dhe prapëseprapë –bazuar në matje të rezultateve të provimeve – nuk kanë mësuar mjaftë, disa prej tyre mezi kanë mësuar pak shkrim-lexim madje edhe pas disa vitesh shkollimi.

Ky zbulim ka ndryshuar perceptimin tonë: derisa koha është e rëndësishme për arsimin, çfarë vërtetë ka rëndësi është **çka dhe si mësojnë fëmijët faktikisht** gjatë asaj kohe, d.m.th. cilësia e arsimit!

Kjo ka qenë pikënisja e hulumtimit të faktorëve që përcaktojnë cilësinë e arsimit.

Prandaj shkollat kanë përgjegjësi të lartë. Ka pritje të mëdha nga qeveritë, grupet e ndryshme të shoqërisë, e poashtu edhe nga prindërit, biznesi dhe industria. Që të gjithë dëshirojnë të marrin të rinjtë të kualifikuar mirë, të cilët nuk rrinë në shkollë shumë gjatë, por e lënë atë me rezultate të larta, me dije praktike dhe teorike sipas standardeve ndërkombëtare të cilësisë. Kështu politikë-bërësit në shtete të ndryshme të botës i formulojnë politikat dhe planet për arsim cilësor. Pasiqë resurset janë të kufizuara është me rëndësi të ndërmerren vendime të informuara të bazuara në të dhëna të shëndosha arsimore.

Në këtë kontekst, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në Planin Strategjik për Arsimin në Kosovë 2011-2016, përcakton qartë njërin nga prioritetet zhvillimore: **përkrrahje e sistemit arsimor gjithëpërfshirës i cili do të ofronte qasje të barabartë në arsim cilësor për të gjithë.**

Prezantimi i Sistemit Menaxhues për Informatat në Arsim (SMIA) është hap i rëndësishëm për t'i pajisur vendim-marrësit në nivel qendror, komunal dhe shkollor me informatat e detajuara të nevojshme që duhen për të menaxhuar arsimin në mënyrë efikase dhe efektive.

Në një studim të realizuar në katër komuna të Kosovës për nivelin e kënaqësisë së prindërve, nxënësve, dhe mësimdhënësve me administratën e shkollës dhe mundësitë për pjesëmarrje në shkollë, tregon se rreth 40% e nxënësve nuk marrin arsim cilësor¹⁵.

Aktiviteti #5 –Në ndërlidhje me katër faqet e mësipërme, ju lutem shqyrtoni e pastaj diskutoni pyetjet në vijim:

1. A përballat shkolla juaj me ndonjë sfidë gjinore? Si do ta dinit nëse është ashtu?
2. Me cilat sfida përballat shkolla juaj në respektimin e qëllimeve 1, 2 dhe 5 të ApGJ?
3. Kur i rishikoni Qëllimet e BE-së a mund t'i identifikoni tri përparësi të shkollës suaj¹⁶
4. Si do ta dinit sa mirë është duke punuar shkolla juaj në raport me standardet e BE-së?

¹⁵ Për më shumë detaje shikoni raportin e studimit të gjendjes fillestare: Ardit Bejko (2011): Niveli i kënaqësisë së prindërve, nxënësve, dhe mësimdhënësve me administratën e shkollës dhe mundësitë për pjesëmarrje në shkollë, IQ Consult Prishtinë
¹⁶ Ju lutem vini re: Cilësia e shkollave të një vendi është performanca mesatare e të gjitha shkollave të saj; prandaj performanca e secilës shkollë veç e veç është e rëndësishme.

Ajo që di është se fëmijët e mi shkojnë rregullisht në shkollë, por nuk e di nëse mësojnë mirë apo jo. Kjo është detyrë e mësimitdhënësit.



E kemi përfunduar shkollën më kot, nuk kemi mësuar asgjë. Tani e shoh në punë se na mungojnë njohuritë dhe shkathtësitë e mjaftueshme.



Po synojmë të rrisim cilësinë në shkollë, e cila varet nga shumë faktorë, kjo nuk është punë e lehtë.



Oh, ne i kemi disa mësimitdhënës që na japin mësim me metoda të reja. Mësimi është bërë argëtues dhe sfidues.

Do të jetë mirë sikur të gjithë mësimitdhënësit japin mësim në atë mënyrë.



6. Edukimi cilësor dhe Zhvillimi Ekonomik

Arsimi përveç që është e drejtë njerëzore themelore, arsimit poashtu është motor për zhvillimin ekonomik. Gjendja e përgjithshme arsimore e popullësisë së një shteti pjesërisht përcakton nivelin e arsimit të fuqisë punëtore të atij shteti (ku përfshihen njerëzit që punojnë si të punësuar apo vetë-punësuar, ndërmarrësit, menaxherët, zyrtarët dhe shumë profesione tjera). Disa shtete i theksojnë komponentët e ndryshëm të arsimit. Për shembull, një shtet që nuk ka program arsimor profesional në shkollat e mesme nuk do të ketë fuqi punëtore 'të shkathtë'.

Fakti që njerëzit janë aseti më i rëndësishëm nuk është i ri: koncepti "Shoqëria e dijes" i referohet shoqërisë dhe ekonomisë së bazuar në dijen e njerëzve të tyre. Në sistemet tregtare botërore

është më pak e rëndësishme ku i gjeni resurset natyrore: më e rëndësishme është nëse shteti ka njerëz që e dinë dhe kuptojnë si t'i përdorin ato resurse për rezultate optimale, të shpikin njohuri, teknika dhe procese të reja dhe i përdorin ato në të njëjtën kohë për përfitime individuale apo përfitime të shoqërisë në përgjithësi.

Ky është lajm shumë i mirë – për të gjitha shtetet! Pasi që ne nuk mund të ndryshojmë përbërjen gjeologjike të tokës dhe gurëve, ne mund të ngrisin nivelin e arsimit të përgjithshëm në shoqëri në masë të madhe brenda një periudhe të caktuar kohe. Shkathtësitë kognitive të popullsisë janë faktor i rëndësishëm për rritje ekonomike.

Pasi që edukimi cilësor ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi zhvillimin ekonomik të një shteti, ai është më shumë në qendër të raportimit, ku sasia nuk vëhet në fokus.

Për të ngritur nivelin e arsimit, nuk është e mjaftueshme të zgjatet koha për arsimim, apo thjeshtë vitet e shkollimit. Mirëqenia ekonomike nuk mund të promovohet përmes zgjatjes së thjeshtë të viteve të arsimit të detyrueshëm apo rritjes së numrit të studentëve që përfundojnë arsimin e lartë.

Prof. Eric A. Hanushek nga SHBA-ja dhe Prof. Ludger Woeßmann nga Gjermania kanë analizuar së bashku marrëdhënien mes arsimit (duke u bazuar në testet ndërkombëtare) dhe performancës ekonomike të shteteve të shumta rreth botës. Rezultatet tregojnë se dallimet në arritjet në mësimnxënie janë më të rëndësishme në shpjegimin e dallimeve mes shteteve në rritjen ekonomike se sa dallimet në mesataren e viteve të shkollimit apo shkallët e regjistrimit të nxënësve/studentëve. Ata përfundojnë:

*“Edukimi cilësor—e matur nga ajo çka njerëzit dinë—ka ndikime të fuqishme mbi mësimin individual, mbi shpërndarjen e të ardhurave dhe mbi rritjen ekonomike.”
(Hanushek/Woeßmann, 2007, f.1)*

Duke u bazuar në hulumtimet e tyre, ata theksojnë se çdo qasje drejt cilësisë më të mirë arsimore duhet të adresojë faktorë të ndryshëm në të njëjtën kohë; nuk është e mjaftueshme dhe madje as e mundshme të rriten shkathtësitë njohëse pa fuqizuar në të njëjtën kohë strukturën themelore të shkollave!

Nga analiza pikëpamjet më të rëndësishme janë:

- Cilësia e performancës dhe trajnimit të mësimdhënësve ka ndikim të fuqishëm në rezultatet e nxënësve.
- Zhvillimi i sistemeve të llogaridhënies bazohet mbi testet e arritshmërisë kognitive të nxënësve për të dhënë shpërblime për performancën e mirë edhe për personelin e shkollës edhe për nxënësit.
- Vendim-marrja e rritur lokale apo autonomia lokale, së bashku me llogaridhënien mund të lehtësojnë këto përmirësime.

Këto pikëpamje shpiejnë në intervenime strukturore në sistemin arsimor dhe ato do të diskutohen më poshtë dhe në seminaret që pasojnë.

Përveç cilësisë së arsimit dhe kualifikimit pasues të fuqisë punëtore ekziston një aspekt tjetër i zhvillimit ekonomik në të cilin arsimit mund të luajë rol qendror. Në botën e sotme asnjë ekonomi nuk mund të përparojë e vetme: në botën e sotme të gjitha shtetet janë të ndërlidhura dhe varen nga njëra tjetra. Prandaj bashkëpunimi ekonomik dhe investimet e huaja direkte janë të rëndësishme për secilin shtet për të plotësuar resurset e veta dhe për të siguruar punësim dhe perspektivë për të gjithë qytetarët. Shtetet edhe garojnë edhe bashkëpunojnë edhe kjo është arsyeja pse është aq e rëndësishme të keni një sistem të fuqishëm arsimor.

Në mbarë botën, të gjithë shtetet janë duke konkurruar për investime të huaja direkte për t'u përpjekur apo thjeshtë për të mbijetuar – shumë shtete mundohen të fitojnë investimet direkte të kompanive të huaja në shtetin e tyre duke ofruar shpërblime siç janë takast e zvogëluara dhe infrastruktura e mirë. Përkundër rëndësisë së këtyre shpërblimeve, prania e fuqisë punëtore të aftë¹⁷, qytetaria e bazuar në dije, sistemi i besueshëm ligjor dhe paqja e qëndrueshme sociale në vend janë përcaktuesit kryesor të vendimeve për investime të korporatave..

Vini re, rreziku që paqja sociale të destabilizohet është më e ulët në shoqëritë që synojnë të kenë shoqëri gjithëpërfshirëse, duke u bazuar në respektin e ndërsjellë dhe tolerancën mes grupeve të ndryshme të popullësisë, duke ofruar qasje të paanshme në shërbime siç është edukimi cilësor për të gjithë.

Arsimi është “barazues”! Në kontekstin e hulumtimeve të tyre mbi arsimin dhe rritjen ekonomike Prof Hanushek dhe Prof Woeßman theksojnë: **“Reduktimi i pabarazive në qasje dhe cilësi arsimore janë dy qëllimet që duhet të ndiqen në të njëjtën kohë që çfarëdo reforme në arsim të jetë e suksesshme.”** (Hanushek/Woeßmann, 2007)

Zhvillimi i resurseve njerëzore është karakteristikë e rëndësishme për secilin shtet. Kosova ka popullatë të re; kjo paraqet privilegj të madh dhe obligim në të njëjtën kohë!

Ky argument paraqitet me këtë shembull të mirë nga statistikat e Kosovës:

ARSIMI –REZULTATET		EKONOMIA-PUNËSIMI I RINISË	
Testi i arritshmërisë me 2010/2011	54.96%	Papunësia e përgjithshme në Kosovë është rreth	37-40%
Provimi i maturës	54.1%	Papunësia e rinisë është rreth	70 %
Kalueshmëria në qershor	42%	Nga numri total, të papunët e pakualifikuar përfaqësojnë	60 %

Aktiviteti #6 – Pyetjet për reflektim dhe diskutim:

1. Në dritën e rëndësisë së arsimit cilësor, pse mendoni se janë rritur aq shumë pritjet për drejtorët e shkollave? Si ndikon kjo tek ju?
2. Cilat janë intervenimet kryesore për të arritur arsimin cilësor?
3. Nëse një shtet si Kosova dëshiron të arrijë arsimin cilësor, çfarë duhet të ndryshohet?
4. Si mund ta përkrahni këtë rrugë drejt arsimit cilësor?

7. Edukimi cilësor: Përkufizimi dhe faktorët përcaktues

Edukimi cilësor është koncept që i referohet një bashkësie të tërë faktoresh. Secili shtet është i ndryshëm sa i përket sistemeve të tij të trajnimit të mësimdhënësve, menaxhimit dhe udhëheqjes, të bazuara në një kontekst të veçantë kulturor, politik, ekonomik dhe social.

¹⁷ Shiko Akin, M., Vlad, V., 2011, “Marrëdhënia mes arsimit dhe Investimeve të Huaja Direkte” në Revistën Europiane të Studimeve Ekonomike e Politike / ejepe-4(1).2011

Megjithatë këto trende dalin nga shtete me sisteme me performancë të lartë duke respektuar se çka është edukimi cilësor.

Prandaj, nuk ekziston një rrugë e vetme që të shpien përpara, por ekzistojnë shumë modele të mira që të zgjedhim prej tyre në aspektin se çka mund të përshtatet për Kosovë dhe që do të funksiononte mirë këtu. Çështje e rëndësishme është të bëjmë zgjedhjet më të mira.

Por si mundet njeriu ta di se një sistem arsimor ka cilësi të lartë? Cilët janë faktorët qendror të cilësisë arsimore? Edukimi cilësor varet nga katër faktorët në vijim:

1. *Standardet ndërkombëtare të mësimdhënies dhe mësimnxënies*
2. *Arsimi profesional i mësimdhënësve dhe trajnimi profesional i mësimdhënësve në-shërbim (Standardet ndërkombëtare)*
3. *“Ska çertifikatë nëse ska qasje” – e cila nënkupton që rezultatet (provimet) e shkollës duhet të jenë të kualifikuara dhe pranuar që nxënësit të mund të fillojnë të studiojnë dhe punojnë pa asnjë problem.*
4. *Sistemi arsimor fleksibil me kërkesa për “mësimin tërëjetësor”*

Shumica e shteteve e hulumtojnë gjendjen e tanishme të cilësisë arsimore dhe gjejnë përparësitë dhe të metat ekzistuese në raport me cilësinë në kontekstin e tyre. Bazuar në të dhëna valide arsimore ata e zhvillojnë sistemin e tyre arsimor në bashkëpunim me universitete, me komunitetin, biznesin dhe industrinë. Është e rëndësishme që arsimi parauniversitar të punojë për së afërmi, së bashku, me të gjithë “pranuesit” e nxënësve. Prandaj janë të nevojshme lloje të ndryshme të shkollave që punojnë së bashku, siç janë shkollat fillore me shkollat e mesme dhe shkollat e mesme me shkollat profesionale. Politika arsimore duhet të mendojë për arsimin nga para-shkollor deri në universitet dhe shkolla profesionale, por poashtu për trajnim të të rriturve (edukimi qytetar). Prandaj Bashkimi Europian ka një program të madh për Mësimin Tërëjetësor¹⁸ i cili financon projektet për arsimin para-universitar, arsimin e lartë, arsimin dhe aftësimin profesional dhe arsimin e të rriturve.

7.1. Masat e Sistemit të Cilësisë

Hulumtuesit kanë analizuar të dhënat e mbarë botës për të gjetur mënyrën për të matur cilësinë e arsimit duke u përpjekur të identifikojnë faktorët që duket se funksionojnë si tregues për tërë sistemin, për të gjetur një “përfaqësim” të cilësisë së arsimit, d.m.th. një tregues që është i rëndësishëm, i matshëm, lehtë i qasshëm dhe që mund të matet gjatë një periudhe kohe për të dokumentuar ndryshimin.

Hanushek dhe Woeßmann kanë gjetur një tregues të tillë tek performanca e nxënësve në matematikë dhe shkencë, e cila mundëson krahasimin e shteteve të ndryshme dhe përparimin gjatë një periudhe kohe brenda një shteti:

*“Masa e cilësisë së arsimit është një **mesatare e thjeshtë e rezultateve në matematikë dhe shkencë në testet ndërkombëtare, të interpretuara si përfaqësim i performancës mesatare arsimore Kjo masë përmbledh shkathtësitë e përgjithshme njohëse, jo vetëm ato të fituara në shkollë. Kështu, pa marrë parasysh nëse shkathtësitë janë fituar në shtëpi, shkolla apo diku tjetër, ato përfshihen në analizën e përparimit arsimor.”**(Hanushek/Woeßmann, 2007, f.5).*

Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) vlerëson shkallën në të cilën nxënësit e moshës 15 vjeçare, afër përfundimit të arsimit të detyrueshëm, kanë fituar disa prej shkathtësive thelbësore për pjesëmarrje të plotë në shoqëri. Treguesit janë leximi, zotërimi i matematikës dhe shkenca (dhe nga viti 2003, zgjidhja e problemeve).

¹⁸ Ju mund të lexoni më shumë për programin europian në faqen e internetit të Komisionit Europian, për shembull në: http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-programme/doc78_en.htm


Derisa punojmë me një tregues për zhvillim kognitiv ne nuk duhet kurrë të harrojmë se edukimi cilësor është më shumë se vetëm zhvillimi kognitiv. Për të kuptuar, analizë, dhe planifikim më të mirë, duhet të punojmë me një grup të tërë treguesish për dimensione të ndryshme të arsimit. Kjo është e nevojshme sepse standardet arsimore kanë për qëllim të zhvillojnë dhe mbështesin kompetenca të ndryshme të nxënësve. Zakonisht i ndajmë në tri ose katër fusha:

1. Kompetecat kognitive të cilat mund të vlerësohen nga teste kombëtare dhe ndërkombëtare
2. Kompetencat (shkathtësitë) metodike siç janë strategjitë prezantuese dhe kreative për të gjetur zgjidhje për probleme; kjo fushë e kompetencave poshtu mund të testohet dhe vlerësohet
3. Kompetencat sociale dhe personale për ta zhvilluar karakterin e nxënësit(në disa shtete janë dy fusha të ndryshme të kompetencës)

Kompetencat personale dhe sociale nuk janë të lehta për t'u vlerësuar, sepse është vështirë të gjenden tregues për këto kompetenca. Prapseprapë secila shkollë duhet të mendojë se si mund t'i përkrahin mësime të këto kompetenca. Kështu që, është e nevojshme të mendojmë për mësime dhe nxënien në shkollë:

- Si duhet të jetë shkolla që nxënësit të kenë mundësinë të zhvillojnë karakterin dhe personalitetin e tyre individual?
- Çfarë lloj i mësime na duhet? Çfarë lloj orgaizimesh na duhen për nxënien?
- Çfarë lloj trajnimesh për mësime në-shërbim dhe arsimim të mësimeve na duhet?

Cilësia e arsimit reflektohet ngushtë në cilësinë e shkollës. Prandaj, të gjitha fushat për zhvillimin e një shkolle të mirë janë pak a shumë të nevojshme për të arritur një cilësi të lartë arsimore. Faktorë të veçantë që tregojnë cilësinë arsimore janë rezultatet dhe suksesi, profesionalizmi dhe kultura e mësimeve se shkollës.



Aktiviteti #7

Analizojeni profilin e shkollës dhe ilustroni me shembuj në të cilët sipas profilit të fushës shkollore mund të punoni pa resurse financiare shtesë dhe mund të arrini arsim të cilësisë së lartë.

8. Të Kuptuarit e Arsimit Cilësor

Fatkeqësisht nuk ka recetë të lehtë për cilësinë arsimore pasi që cilësia është rezultat i shumë faktorëve që janë të ndërvarur dhe e ndikojnë njëri tjetrin në mënyrë reciproke.

Kontribuesit e përgjithshëm në përmirësimin e cilësisë së arsimit përfshijnë:

Trajnimin efektiv të mësimitdhënësve, të mbështetur me një sistem efektiv të certifikimit të mësimitdhënësve;


Praktikat efektive të mësimitdhënësve;

Lidershipin dhe menaxhimin efektiv;

Transparencës së rritur përmes publikimit të arritjeve arsimore të shkollave dhe mësimitdhënësve, dhe përmes fuqizimit të llogaridhënies së sektorit të arsimit tek palët e interesuara (interesimeve individuale) dhe komunitetit të përgjithësi.

Kontrollit vendor të shkollës dhe përfshirjes së komunitetit përmes shoqatave të prindërve.

Dëshmitë nga hulumtimet në mënyrë të vazhdueshme tregojnë se fuqizimi i mësimitdhënies dhe mësimitnxënies është faktori më i rëndësishëm individual për përmirësimin e cilësisë arsimore. Megjithatë, ajo çka ndodh në një klasë nuk është e izoluar nga ajo që ndodh në shkollë apo në sistemin arsimor. Për ta ilustruar këtë në formë diagrami (shih faqen në vijim), nxënësi paraqitet në qendër, mësimitdhënësia dhe mësimitnxënësia formojnë rrethin e dytë, burimet njerëzore dhe fizike formojnë rrethin e tretë derisa mjedisi i përshtatshëm përbëhet nga qeverisja e shkollës, DKA dhe MASHT-i. Korniza ligjore është rrethi i jashtëm. Ajo pasqyron pritjet e shoqërisë për shkollë, të përfaqësuara në ligj.



Në qendër të arsimit është nxënësi dhe zhvillimi gjithëpërfshirës i tij/e saj. Nxënësit nuk vijnë në shkollë si një fletë e bardhë e zbrazët, por ai/ajo ka fituar tashmë njohuri dhe shkathtësi dhe qëndrime nga shtëpia dhe nga komuniteti i gjerë.

Nxënësit, kur hynjë në shkollë, kanë një perceptim për statusin e tyre dhe kanë pritjet e tyre: të jenë optimist dhe dëshirojnë të përpiqen: ata kanë frikë nga dështimi. Përvoja e tyre personale i bënë ata që ta gjykojnë shkollën si vend të mrekullueshem ose si vend të frikshëm.

Është detyrë e shkollës t'i mirëpres të gjithë nxënësit e ndryshëm, t'i bëjë të ndihen të rehat në mënyrë që ata të mund të mësojnë dhe zhvillojnë potencialin e tyre.

Kjo është një sfidë për shumë **mësimdhënës**: Për mësimdhënësin duhet më shumë se sa njohuria e lëndës që ta zotërojë diversitetin e fëmijëve në një klasë, të jetë në gjendje t'iu shpjegojë dhe t'i nxisë nxënësit të hulumtojnë, të krijojë një mjedis miqësor për nxënës që përfshinë të gjithë nxënësit e ndryshëm me përparësitë dhe mangësitë e tyre: të krijojë një mjedis të mirë dhe nxitje për mësimnxënie dhe zhvillim. Ekziston nevojë për më shumë mësimdhënës të trajnuar mirë. Vendët që kanë arritur standarde të larta në nxënie kanë investuar shumë në profesionin e mësimdhënies.

Mësimdhënia e mirë varet gjithashtu në një numër faktorësh lehtësues.

Disa nga faktorët më të rëndësishëm janë:

Kualifikimi i mësimdhënësit: të gjitha studimet e 10 viteve të fundit për faktorët më të rëndësishëm për një arsim të mirë kanë rezultat të njëjtë (Helmke, 2007). Mësimdhënësi si person është domethënës dhe i rëndësishëm për mësimdhëniën dhe mësimnxëniën. Profesionalizmi i tij/saj si nismëtar, mbështetës, moderator, këshillues, udhëheqës, etj është faktor përcaktues për cilësi të lartë.

Koha e mësimnxënies. Koha e mësimdhënies është element vendimtar për arritshmëri: standardi i pajtuar gjerësisht prej 850-1,000 orë të mësimdhënies për një vit për të gjithë nxënësit nuk arrihet në shumë shtete. Rezultatet e testeve tregojnë qartësisht se sasia e kohës e kaluar në klasë në matematikë, shkencë dhe gjuhë ka ndikim të madh në performancën në këto lëndë. Por mësimdhënësit poashtu duhet të kenë njohuri në menaxhimin e klasës, sepse shpesh koha nuk përdoret për mësimnxënie por për menaxhim.

Kurrikula relevante/Lëndët bërthamë – Shkrim-leximi është mjet vendimtar për të mësuar lëndet tjera. Leximi duhet të konsiderohet si fushë prioritare në përpjekje për të përmirësuar cilësinë e arsimit bazik, posaçërisht për nxënësit nga grupe të pafavorizuara.

Metodat e mësimdhënies/Pedagogjia – Stilet e mësimdhënies që më se shumti përdoren nuk iu shërbejnë mirë nxënësve: ato shpesh janë shumë të ngurta dhe bazohen shumë në të mësuarit përmendësh, duke i vendur nxënësit në rol pasiv. Shumë hulumtues arsimor promovojnë një qasje të mësimdhënies e cila kombinon mësimdhëniën direkte, praktikën e mbikëqyrur dhe nxëniën e pavarur.

Politika e gjithëpërfshirjes – Gjithëpërfshirja është një aspekt i rëndësishëm i arsimit: Ajo synon t'iu mundësojë mësimdhënësve dhe nxënësve të ndihen rehat me diversitetin dhe ta shohin atë si sfidë dhe pasurim të mjedisit të mësimnxënies, jo si problem.

Materialet për mësimdhënie dhe mësimnxënie – Cilësia dhe disponueshmëria e materialeve për mësimnxënie ka ndikim të madh në atë se çfarë mësimdhënësit mund të bëjnë. Mungesa e teksteve shkollore, materialeve të mira për mësimdhënie dhe mësimnxënie është mangësi e madhe për të arritur rezultate të mira.

Infrastruktura fizike/Objektet – Renovimi dhe ndërtimi i klasave është i nevojshëm në shumë shtete. Uji i pastër, instalimet hidro-sanitare dhe qasja për nxënësit me paafësi janë tepër të rëndësishme.

Udhëheqja – Qeveritë qendore duhet të jenë të gatshme t'iu japin liri më të madhe shkollave, me kusht që janë në dispozicion resurse adekuate dhe që rolet dhe përgjegjësitë janë përkufizuar qartë. Kujdestarët/drejtorët kanë një ndikim të madh në cilësinë e shkollave.

Përtej nivelit të shkollës ka faktorë kontekstual, si gjendja ekonomike, politikat kryesore kombëtare, strategjitë arsimore, pritjet publike për arsim, standardet kombëtare, kërkesat e tregut të punës, etj. Këta faktorë përcaktojnë kontekstin në të cilin ndodhë mësimdhënia dhe mësimnxënia.


Kjo kornizë ¹⁹ tregon faktorët e ndryshëm që ndikojnë në cilësinë arsimore.

Lista e faktorëve të dhënë si shembuj është e gjatë: disa prej tyre mund të jenë të rëndësishëm në një shtet dhe të parëndësishëm në një tjetër.

Prandaj secili shtet duhet të analizojë dhe vendos për faktorët më të rëndësishëm në situatën specifike.

Ky proces ka nevojë për udhëheqje të fuqishme! Përkushtimi i lartë politik për arsim më të mirë në nivelin qendror, komunal, dhe shkollor është parakusht.

Ju lutem gjeneroni faktorët e përmendur më lartë në grafikonin e mëposhtëm.




Aktiviteti #8 – Pyetjet për diskutim:

1. Cilët janë faktorët më të rëndësishëm lehtësues për nxënësit në Kosovë?
2. Cilët nga këta faktorë lehtësues i kontrollojnë apo ndikojnë shkollat?
3. Rendisni faktorët lehtësues të emëruar në skicë sipas rëndësisë së tyre për shkollën tuaj.
4. Cilët janë tre faktorët më të rëndësishëm 'kontekstual' në Kosovë?

Mënyra si mësimdhënësit dhe nxënësit bashkëveprojnë në klasë dhe përdorin materialet e mësimdhënies është çelës për arsimin cilësor në shkollë.

Faktorët kryesor të identifikuar që ndikojnë në avancimin e performancës së nxënësve dhe rezultatet e cilësisë arsimore janë paraqitur në tabelën në vijim.

¹⁹ Bazuar në GMR 2005




8.1. Roli i menaxhmentit të shkollës në edukimin cilësor

Me përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave mësimore, udhëheqësit arsimor krijojnë dhe ofrojnë mundësi për shumë fëmijë që të përfitojnë dhe marrin njohuri, zhvillojnë shkathtësi esenciale për jetë, dhe qëndrime bazë për jetën e tyre. Shkollat e suksesshme dhe edukimi cilësor arrihen si rezultat i menaxhmentit të përkushtuar në punë dhe cilësi. Nuk mund të ketë cilësi në shkollë pa udhëheqje dhe menaxhment cilësor dhe efektiv. Udhëheqësit arsimor efektiv i ndihmojnë shkollat e tyre të përgatisin një vizion që përmban nivel të lartë të përkushtimit në mësimdhënie dhe mësimit – si parakusht për arsim cilësor në shkollat e tyre.

Drejtorët e shkollave kanë rol të rëndësishëm në arritjen e cilësisë së mirë arsimore: Ata janë menaxherë të disa prej faktorëve më të rëndësishëm lehtësues e kontekstual (të cilët u paraqiten më lartë) dhe mund të ndikojnë në mënyrë efektive procesin e mësimdhënies në klasë.

Puna e drejtorëve të shkollave është pashmangshëm e ndërlidhur me arsimin cilësor. E kemi përmendur këtë disa herë deri me tani në këtë seminar. Në mënyrë që drejtorët e shkollave të kenë një pasqyrë më të qartë të qasjes së përdorur nga udhëheqësit dhe menaxherët efektiv për të siguruar arsimin cilësor në institucionet e tyre, ua paraqesim grafikonin në vijim. Nuk është e mjaftueshme të thuhet se në këtë grafikon është paraqitur një mënyrë e menaxhimit cilësor dhe arsim cilësor. Në të kundërtën, duhet të përmendim se menaxhimi i plotë cilësor dhe funksionimi i këtij graficoni në arsim varet në tre faktorë kryesor: i) besim; ii) menaxhim dhe udhëheqje; dhe iii) fuqizim.



8.2. Standardet për Menaxhim dhe Udhëheqje të Cilësisë në Shkollë

Me qëllim që të pasurohet e plotësohet korniza ligjore në Kosovë, MASHT ka përgatitur dokumentin: **Standardet e Praktikës Profesionale për Drejtorët e Shkollave në Kosovë**. Ky dokument tani është UA 04/2012. Ai përcakton standardet themelore për drejtorët e shkollave të cilat shërbejnë si pikënisje për trajnim dhe avancim profesional të udhëheqësve arsimor në Kosovë. Është me rëndësi që të mos shikohen vetëm pjesët e menaxhmentit. Drejtori i shkollës është udhëheqës i çështjeve teknike, por ajo që është më e rëndësishme, ai/ajo është udhëheqës i qenieve njerëzore. Prandaj udhëheqja është faktor i rëndësishëm për çdo institucion arsimor.

Standardet e Praktikës Profesionale për Drejtorët e Shkollave në Kosovë

Standardi	Përshkrimi
Udhëheqja dhe motivimi	<i>Drejtori i shkollës nxit suksesin e shkollës dhe të nxënësve duke lehtësuar zhvillimin, artikullimin dhe zbatimin e vizionit të mësimnxënies i pasqyruar në vlerat, misionin dhe objektivat e përbashkëta të shkollës e poashtu edhe në mësimdhënien në klasë.</i>
Mësimdhënia dhe mësimnxënia cilësore	<i>Drejtori i shkollës siguron qasje të vazhdueshme në mësimdhënie e mësimnxënie cilësore për të gjithë nxënësit përmes zbatimit të një kulture shkollore që vlerëson e përkrah mundësi të barabarta për mësimnxënie për nxënësit dhe zhvillimin profesional të stafit.</i>
Planifikimi dhe Menaxhimi	<i>Drejtori i shkollës menaxhon shkollën, aktivitetet dhe resurset shkollore për të siguruar një mjedis arsimor të sigurtë, të shëndoshë dhe efektiv.</i>

Kooperimi dhe Bashkëpunimi	<i>Drejtori i shkollës ka marrëdhënie të mira me komunitetin e shkollës (nxënësit, prindërit, stafin, bordin udhëheqës të shkollës dhe akterët tjerë) e poashtu promovon udhëheqjen e përbashkët në harmoni me interesat e nxënësve nga komuniteti.</i>
Legjislacioni dhe Shoqëria	<i>Drejtori i shkollës kupton dhe vepron me përgjegjësi drejt konteksteve politike, shoqërore, ekonomike, ligjore e kulturore që kanë ndikim në shkollë.</i>
Etika profesionale	<i>Drejtori i shkollës vepron drejt, me ndershmëri dhe etikë të lartë.</i>

Aktiviteti #9 – Pyetjet për reflektim dhe diskutim:

1. Cilët faktorë kontekstual dhe lehtësues janë në përgjegjësi të drejtorëve të shkollave?
2. Si do t'i vlerësonit kapacitetet tuaja për të plotësuar standardet?
3. Në cilat fusha nevojitet më shumë përkrahje?

8.3. Fushat e Cilësisë për Zhvillimin e Shkollës

Për të fuqizuar cilësinë e arsimit në një shkollë të caktuar është e rëndësishme të analizohet gjendja aktuale e shkollës.

Si pikënisje është të shikohen rezultatet e shkollës, duke përdorur rezultatet e arritshmërisë në matematikë dhe shkenca.

Aktiviteti #10 – Pyetjet për diskutim:

1. Cilat janë rezultatet e semi-maturës në shkollën tuaj në matematikë dhe shkenca?
2. A ka dallime në arritshmëri mes vajzave dhe djemëve, po mes fëmijëve të grupeve të ndryshme etnike?

Përveç performancës së nxënësve ka edhe fusha tjera që mund të hulumtohen për të patur një ide më të qartë për cilësinë në arsim në shkollë dhe të cilat janë nën kontrollin e drejtorit të shkollës.

Këto fusha ndërlihen me faktorët për cilësinë arsimore të përmendur më lartë dhe grupimin e tyre me fushat e cilësisë.

Kultura e mësimnxënies: Kurrikula e shkollës; synimet; metodat e përmbajtjes; mundësitë për mësimnxënie për zhvillim personal; strukturimi i mësimdhënies; qasja e mësimdhënësve në kërkesat për performancën në klasë dhe informatat kthyesë mbi arritshmërinë duke adresuar nevoja të ndryshme të mësimnxënies, Koha e Mësimnxënies Efektive (Koha në Detyrë);

Kultura shkollore: Atmosfera shoqërore në shkollë dhe në klasë, pjesëmarrja e nxënësve dhe prindërve, sinqeriteti i shkollës dhe bashkëpunimi me partnerët e jashtëm, sistemet përkrahëse për nxënësit, integrimi i nxënësve të rinj, gjithëpërfshirja (sfida e të qenit gjithëpërfshirës), pjesëmarrja e komunitetit, Këshill Drejtues i Shkollës – është aktiv, mungesa e dhunës, etj.

Zhvillimi profesional: Zhvillimi i personelit i bazuar në qëllime, bashkëpunimi i mësimdhënësve, profesionalizmi, menaxhimi i personelit, menaxhimi strategjik, zhvillimi profesional strategjik i udhëheqjes së shkollës dhe mësimdhënësve (duke marrë parasysh nevojat në të ardhmen) dhe përkrahja kolegu-për-kolegun.

Aktiviteti #12 – Fleta e punës

Ju lutem përshkruani aspektet më të rëndësishme të fushave të cilësisë në shkollën tuaj.

Fusha e Cilësisë	Çfarë do të thotë kjo në kontekstin e Kosovës – në shkollën tuaj?
Rezultatet dhe suksesi i shkollës:	
Profesionalizmi i mësimitdhënësve dhe zhvillimi i personelit:	
Kultura e mësimitnxënies:	
Kultura Shkollore	

Pyetjet e mundshme për diskutim:

1. Cili është roli i shkollës në Kosovë?
2. Cili është roli i shkollës në zhvillimin e politikave për arsim cilësor?
3. Cilat janë disa prej rregullave të shkollës që garantojnë arsimin cilësor për të gjithë?
4. Cili është roli i komunitetit të shkollës në këtë kontekst?

Fjalorthi

Cilësia – do të thotë sa e mirë apo e keqe është diçka; ‘Cilësisë’ zakonisht i referohemi në aspektin e pritjeve të larta për performancë dhe/ose rezultate.

Kultura – mënyra e jetës; në shkollë janë praktikatat dhe besimet që udhëheqin sjelljen dhe marrëdhëniet në një moment të caktuar kohe (që nënkupton se kulturat ndryshojnë)

Llogaridhënia – është të qenit plotësisht përgjegjës për atë që është bërë dhe ofrimi i arsyeve për veprimet dhe vendimet e ndërmarra.

Standardi(et) – është deklaratim i objektivave që përcaktojnë cilësinë e performancës; një grup deklaratash që përcaktojnë çfarë duhet të dinë dhe të bëjnë individët në përmbushjen e roleve të tyre; një grup deklaratash që identifikon çfarë nivelesh të arritshmërisë priten dhe janë të arritshme.

Udhëheqja – përfshin shkathtësitë dhe aftësitë e një individi a grupi të individëve për të bindur të tjerët të zbatojnë ndryshimin apo të krijojnë praktika të reja.

Vlerësimi - është proces i të kuptuarit e asaj që vëzhgohet apo që bëhet e dukshme përmes matjes së performancës (p.sh. mësimitnxënia e nxënësve, cilësia e shkollës, etj.)

Zbatimi – vënia e një plani a sistemi në funksion (p.sh. kurrikula e re)

Referencat

- Fullan, Michael Udhëheqja në Kulturën e Ndryshimit (pa datë)
- Republika e Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës: <http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,100,48>
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Republika e Kosovës, Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë 2011-2016: <http://www.masht-gov.net/advCms/#id=62>
- Kombet e Bashkuara, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut: <http://www.un.org/en/documents/udhr/>
- Kombet e Bashkuara, Konventa për të Drejtat e Fëmijës: <http://www2.ohchr.org/english/laë/crc.htm>
- Kombet e Bashkuara, Qëllimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit: <http://www.un.org/millenniumgoals/>
- Banka Botërore, Arsimi Për të Gjithë (APGj): <http://web.worldbank.org/ËBSITE/EXTERNAL/ TOPICS/ EXTEDUCATION/0,,contentMDK:20374062~menuPK:540090~pagePK:148956~piPK:216618~theSitePK:282386,00.html>
- Komisioni Europian, Traktati i Lisbonës: http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-policy/doc30_de.htm
- Komisioni i Komuniteteve Europiane, Objektivat e BE-së dhe Trajnimi (Standardet 2010-2020), 2011: http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-policy/doc/report10/report_en.pdf
- Hanushek/Woelfmann, 2007, f.1
- Akin, M., Vlad, V., 2011, "Marrëdhënia mes arsimit dhe Investimeve të Huaja Direkte" në Revistën Europiane për Studime Ekonomike dhe të Politikave / ejeps-4(1).2011
- Bashkimi Europian, Programi Europian për Mësimin Tërëjetësor: http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-programme/doc78_en.htm

**SEMINARI I NJË:
PJESA E DYTË
EDUKIMI CILËSOR
SHKOLLAT E MIRA**

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	36
1.1. Qëllimi i seminarit.....	36
1.2. Performanca e pritur.....	37
2. Çka nënkuptojmë më një shkollë të mirë?	38
2.1. Çfarë e bën një shkollë të mirë?.....	38
2.2. Kultura e mësimdhënies dhe nxënies.....	41
2.2.1. Shkollave iu duhet mësimdhënie e cilësisë së lartë për të qenë të mira!	42
2.3. Gjithëpërfshirja.....	43
2.4. Kultura shkollore.....	45
2.4.1. Aktivitetet jashtë-kurrikulare.....	45
2.5. Rregullat e shkollës dhe kultura shkollore.....	45
2.5.1. Qëllimet e rregullave të sjelljes në shkollë.....	46
3. Standardet për shkollat mike për fëmijë	48
Fjalorthi	55
Referencat.....	56

1. Hyrje

Njëra nga detyrat kryesore të drejtorit të shkollës është të sigurohet që shkolla është ma e mira që mund të jetë. Si udhëheqës dhe menaxher i ekipit drejtor i shkollës duhet të analizojë situatën aktuale në shkollë, të zhvillojë bashkë me mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit qëllimet afatgjata dhe një plan për t'i arritur ato; pastaj të drejtojë planin e zbatimit. Hapi i parë në këtë rrugëtim është çmuarja dhe vlerësimi i efektivitetit të operacioneve të shkollës sot.

Institucionet arsimore kryejnë analiza dhe hulumtime në mënyrë që të konstatojnë nivelin e tyre të performancës në krahasim me qëllimet e parapara, qoftë në nivelin ndërkombëtar, kombëtar, komunal apo në nivelin e shkollës (siç është artikulluar në vizionin e shkollës). Pjesa A e këtij seminari mbi cilësinë arsimore ka prezantuar disa tregues të rëndësishëm që kanë të bëjnë me cilësinë. Krahasimi po ashtu mund të kryhet mes shkollave: shkollat me strukturë të ngjashme të nxënësve duhet të arrijnë rezultate të ngjashme. Nëse një shkollë arrin nivel më të lartë se sa një tjetër atëherë shkolla që ka performancë më të fuqishme mund ta ndihmojë atë që është më e dobët.

Ku fillojnë drejtorit të shkollës dhe Këshilli Drejtues i Shkollës të konstatojnë se çka është e nevojshme për të përmirësuar shkollën? Hapi i parë është të shtrohen pyetje si "Çfarë lloj shkolle dëshirojmë të bëhemi në planin afat-gjatë?" "Çfarë lloji dhe cilësie të shkollës dëshirojmë?" "Sa e mirë është shkolla jonë ashtu siç është tani?" "Si e dimë këtë?" "Cilat janë mangësitë?" "Cilat janë përparësitë?" Përgjigjet gjinden në të dhëna . Nevojitet vlerësimi dhe analiza e situatës aktuale për të identifikuar përmirësimet e dëshiruara në shkollë. Njohuritë dhe shkathtësitë që do të fitohen në këtë seminar ndërlidhen me njohuritë dhe shkathtësitë që do të fitohen në Seminarin 3 mbi Zhvillimin e Shkollës dhe Seminarin 6 mbi Menaxhimin e Projektit.

Seminari përshkruan se çka është shkolla e mirë; cilët janë faktorët dhe elementet që përbëjnë një 'shkollë të mirë' dhe se si ndërlidhen ato. Seminari poashtu ofron modele të praktikave të mira në çmuarjen dhe vlerësimin e shkollës që ka të bëjë me efikasitetin dhe efektivitetin e shkollës.

1.1. Qëllimi i seminarit

Seminari ofron njohuri bazë mbi karakteristikat e 'shkollës së mirë' që ndërlidhen me standardet e cilësisë, të përcaktuara përmes hulumtimit i cili ka identifikuar karakteristikat e 'shkollës së mirë'. Si rrjedhojë, shkollat tani mund të vlerësojnë cilësinë e tyre dhe me zhvillimin e vizionit afatgjatë e definojnë atë se ku duan të arrijnë. Vizioni krijohet në bashkëpunim me mësimdhënësit, prindërit dhe Bordin Udhëheqës të Shkollës. Ai e fokuson shkollën në përmirësimet e dëshiruara në performancën e shkollës.

Objektivat e seminarit janë:

- T'u ofrojë drejtorëve të shkollës shkathtësi dhe njohuri për të rritur nivelin e kënaqësisë së nxënësve, mësimdhënësve, stafit të shkollës dhe prindërve me cilësinë e arsimit dhe shërbimet e tjera të shkollës;
- Të mbështeten drejtoret në aspektet që lidhen me mësimdhënien dhe nxënien në shkollë, se si të krijohet një plan për zhvillimin e shkollës (PZhSh) duke u bazuar në tregues të cilësisë, përfshirjen e stafit, prindërit dhe bordin udhëheqës të shkollës i cili adreson nevojat e identifikuar.

1.2. Performanca e pritur

Pritet që pjesëmarrësit do të arrijnë rezultatet themelore në vijim sa i përket 'njohurive':

- Të kuptojnë esencën se çka është shkolla e mirë
- Të çmojnë rëndësinë e treguesve të cilësisë mbi të cilët bazohet 'shkolla e mirë'
- Të rrisin vlerësimin e mësimdhënies e mësimnxënies së mirë
- Të kuptojnë veglat e vlerësimit të përdorura për të arritur në gjykime lidhur me atë se sa mirë është duke punuar shkolla
- Të kuptojmë instrumentet e dhëna në udhëzimet për vlerësimin gjatë secilës fazë të hulumtimit dhe në vlerësimin e shkollës

Dhe, këto rezultate ndërlidhen me zhvillimin e 'shkathtësive':

- Të jenë në gjendje të përdorin veglat e ofruara në udhëzimet për vlerësim
- Të jenë në gjendje të praktikojnë monitorimin dhe vlerësimin brenda shkollës
- Të jenë në gjendje të ndajnë atë që e mësojnë në lidhje me 'shkollat e mira' me stafin, prindërit dhe bordin udhëheqës të shkollës.
- Të udhëheqin stafin, prindërit, nxënësit, dhe Bordin Udhëheqës të Shkollës në procesin e zhvillimit të misionit, vizionit dhe qëllimeve për shkollën.

2. Çka nënkuptojmë më një shkollë të mirë?

Çështja për përcaktimin e një shkollë të mirë është shumë-dimensionale. Kur punëtorët arsimor nuk e dinë se cilat janë cilësitë e një shkollë më performancë të lartë, ata janë të kënaqur me atë që është, pa e kuptuar se çka mund të jetë.

Më tej "çka është" mund të mos jetë në pajtueshmëri me aspiratat e prindërve, nxënësve apo komunitetin e gjerë. Ndonjëherë, krahasimi me shkolla të tjera mund të tregojë se ka "vend për përmirësim".

Shpesh drejtorët e shkollave e dinë që kanë nevojë për përmirësime por nuk dinë se çfarë mund të bëjnë në lidhje me atë. Ata presin zgjidhje nga jashtë, që nuk është një reagim adekuat pasi që ka aq shumë përmirësime që nuk kërkojnë fare buxhet; ato kërkojnë përdorimin dhe zgjerimin e ekspertizës së drejtorit, të mësimdhënësve dhe të tjerëve që kanë një të kuptuar sistematik të situatës.

Personeli i shkollës duhet t'i njoh përgjegjësitë e tyre për cilësinë e shkollës.

Qëndrimi i nevojshëm është: "ne" jemi

Shkollë e mirë është ajo e cila:

- Përkrah zhvillimin gjithëpërfshirës të potencialeve të secilit nxënës d.m.th. kognitiv, emocional, shoqëror dhe fizik;
- Mundëson zhvillimin maksimal të njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të nxënësve për shekullin 21.
- Bazon filozofinë & praktikën e saj në gjithëpërfshirje,
- Ndjek progresin e secilit nxënës
- Përgatit nxënësit për mësimin tërëjetësor,
- Ka secilin nxënës në qendër të të gjitha veprimeve.
- Arrin suksese dhe rezultate të larta, dhe i dokumenton ato me të dhëna valide dhe të besueshme
- Përdorë praktika të mësimdhënies të bazuara në metodologji të dëshmuara nga hulumtimet
- Krijon një kulturë të mësimnxënies stimuluese dhe inkurajuese përmes kualitetit të mësimdhënies dhe mësimnxënies,
- Ka një Bord funksional për Udhëheqje të Shkollës;
- Krijon një klimë pozitive në shkollë,
- Bashkëpunon me palët kryesore të interesit dhe më partnerët,
- Zhvillohet (përmirësohet) vazhdimisht.

përgjegjës për këtë shkollë. Shkollat përmirësohen nga brenda me ndihmë nga jashtë.

Një vlerësim efektiv i shkollës do të tregojë arritshmëritë dhe mangësitë e saj. Ka çdo herë vend për përmirësim, rritje të rezultateve të shkollës, për t'i rritur arritshmëritë dhe për të hapur perspektiva të reja sa i përket kërkesave të shekullit 21.



2.1. Çfarë e bën një shkollë të mirë?

“Çfarë e bën një shkollë të mirë” Kjo është një pyetje e rëndësishme e cila ka qenë temë e hulumtimeve për më shumë se 30 vjet; ka qenë temë qendrore e konferencave dhe publikimeve. Karakteristikat e një shkollë të mirë tashmë janë të njohura dhe për ato është arritur pajtim nga hulumtuesit. Ato duhet të jenë të njohura dhe të kuptueshme nga profesionistët, drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit, ashtu që këta të udhëheqin procesin e zhvillimit të shkollës dhe janë kryesorët për cilësinë e shkollës.

Profili i një shkollë të suksesshme dhe të orientuar kah performanca gjendet në fushat cilësore të cekura më poshtë. Ato janë pika referente për “një shkollë të mirë”. Në studime të ndryshme, mund të ketë fokusime pak më ndryshe në fusha cilësore të ndryshme por në esencë të gjitha lidhen me përshkrimi e cituar në këtë seminar. Grafikoni në vijim tregon fushat cilësore relevante të një shkollë në Kosovë. Këto karakteristika janë vlerësimet dhe planifikimet themelore të shkollës. Ato u zhvilluan në një punëtori me përfaqësues nga nivelet qendrore, komunale dhe shkollore e poashtu edhe ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë në Prishtinë në vitin 2011.

Secili nga këto elemente ndërlidhet direkt me secilin nga të tjerët dhe ndikon në cilësinë e tyre. Për shembull, rezultatet e larta dhe suksesi i madh arrihet vetëm me mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore. Më tutje, kjo nuk mund të ekzistojë nëse mësimdhënësit nuk janë të profesionalizuar. **Prandaj kualifikimi dhe standardet e praktikës profesionale të mësimdhënësve janë më të rëndësishmet për një shkollë të mirë dhe të suksesshme. Cilësitë e udhëheqjes së drejtorëve të shkollave janë përcaktues kryesor për cilësinë e shkollës. “Shkollat e mira kërkojnë drejtorë kompetent”.**

Në ditët e sotme roli i mësimdhënësve është i ndryshëm. Ata janë planifikues për mësimdhënie, trajner për mësimdhënie dhe nxënie, mentor, përkrahës për nxënësit dhe palët tjera të interesit në tërë procesin për zhvillimin e shkollës. Shkolla është vend për mësimnxënie dhe “për të jetuar”, që nënkupton se të gjitha palët tjera të interesit duhet t’i njohin cilësitë e një shkolle të mirë dhe se çfarë nevojitet për t’u bërë e tillë.

Shikoni tabelën e mëposhtme, ku secila fushë ka treguesit e vet për cilësi. Niveli i përmbushjes së cilësisë është ai që dallon shkollën nga shkolla. Të gjitha këto fusha janë të rëndësishme, por një është kryesore për suksesin e shkollës: për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Rezultatet e larta dhe sukcesi i mirë nuk mund të arrihen pa mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore. Mësimdhënësit duhet ta rrisin praktikën e tyre në formë profesionale në nivel teknik dhe ta pranojnë se të mësojnë si të japin mësim mirë është një kërkim gjatë gjithë karrierës. Prandaj, trajnimi dhe promovimi i standardeve të larta për praktikën profesionale të mësimdhënësve është shumë i rëndësishëm për një shkollë të mirë dhe të suksesshme. Pjesa tjetër e rëndësishme është drejtori i shkollës me kompetencat e tij/saj në udhëheqje dhe menaxhim. Ky person është filluesi dhe motori për zhvillimin e shkollës.

Fushat e cilësisë	Disa tregues të cilësisë
Rezultatet dhe sukseset	<ul style="list-style-type: none"> - Shkalla e kalueshmërisë pas klasës së pestë dhe semi-maturës, veçanërisht në lëndët: gjuhë, matematikë dhe shkencë; - Ekspertiza në një lëndë specifike (e mësimdhënësve) - Niveli i përfundimit të shkollës dhe edukimi i mëtutjeshëm - Niveli i kënaqësisë me shkollën nga mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit; - Niveli i kompetencave shoqërore, personale dhe kognitive të nxënësve; - Cilësia i mësimdhënies - Marrëdhënia me standardet ndërkombëtare të arsimit - Qasja pas ndonjë certifikimi.
Kultura dhe cilësia e mësimdhënies dhe nxënies	<ul style="list-style-type: none"> - Kurrikula relevante e shkollës, duke përfshirë lëndët zgjedhore - Fokusimi në kompetencat e nxënësit, rezultatet e të nxënit, përmbajtja dhe metodat. - Interesim dhe përcjellje e zhvillimit dhe progresit të secilit nxënës - Mundësitë e mësimnxënies: arsimit jo formal - Pedagogjia: Qasja e mësimdhënësve në klasë - Dhjetë faktorët për mësimdhënie dhe mësimnxënie të mirë (Helmke, 2009 – shikoni f. 12)
Kultura e shkollës	<ul style="list-style-type: none"> - Klimë shoqërore miqësore ndaj fëmijëve në shkollë dhe në klasë - Besim i ndërsjellë dhe përgjigje të respektueshme - Pjesëmarrja e nxënësve dhe mësimdhënësve në shkollë - Këshilli Udhëheqës i Shkollës, Mësimdhënësit, Këshilli i Nxënësve dhe Prindërve - Shkollë e hapur dhe bashkëpunim me partner jashtë shkollës - Sisteme përkrahëse për nxënës (si rrjet) - Aktivitetet jashtë-kurrikulare - “Kodi i Sjelljes”, rregulloret për sjellje, forcimi i sigurisë dhe mësimnxënies: sigurimi i disiplinës dhe rregullit në shkollë për të gjithë - Vizioni i shkollës dhe cilësia e synimeve, të cilat mundohen t’i realizojnë se bashku të gjitha palët e ndryshme të interesit. - Kultura e komunikimit dhe këshilla reciproke - Kultura dhe zhvillimi i gjithëpërfshirjes së vërtetë

Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollës	<ul style="list-style-type: none"> - Fillimi dhe motivimi i zhvillimit të shkollës - Performanca e udhëheqjes së shkollës: menaxhimi strategjik dhe udhëheqja cilësore - Udhëheqje personale për mësimdhënës dhe nxënës - Zhvillimi i profesionalizimit të mësimdhënësve - Vlerësimi i performances së mësimdhënësve - Udhëheqja e shkollës që nxit pjesëmarrjen - Menaxhimi i cilësisë së shkollës bazuar në të dhëna - Administrata dhe menaxhimi i resurseve - Zhvillimi me kohë dhe kompetent i orareve mësimore - Menaxhimi operacional efektiv
Profesionalizimi i mësimdhënësve	<ul style="list-style-type: none"> - Njohuri për mësimdhënien dhe mësimnxënien e bazuar në studimet shkencore - Njohuri për mentorim të nxënësve - Strategji për të krijuar mjedise për mësimnxënie për zhvillimin, dhe vet-veprimin e nxënësve - Menaxhimi i klasës dhe menaxhimi pedagogjik i heterogjenitetit dhe githëpërfshirja - Zhvillimi profesional bazuar në nevojat për përmirësim të vazhdueshëm. - Komunikimi dhe bashkëpunimi i rregullt në mes mësimdhënësve - Mësimdhënia ekipore - Profesionalizimi: standardet e mësimdhënies, përgatitja e orëve mësimore, vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve, reflektim mbi performancën e tyre/ vet-vlerësimi - Përkrahje dhe këshilla në mes kolegëve - Këshilla dhe partneritet me prindërit
Strategjia për zhvillimin e fokusit dhe cilësisë	<ul style="list-style-type: none"> - Orientim kah një vizion me qëllime afatgjata - Qëllime relevante dhe afat mesme për të përmirësuar cilësinë - Njohuri për strategjitë dhe metodat e arritjes së qëllimeve, njohuri për vlerësim, metodat për vlerësimin dhe menaxhimin e tyre - Vlerësimi dhe zhvillimi i shkollës - Vlerësimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies - Vlerësimi krahasues dhe dokumentimi i rezultateve - Njohuri mbi interpretimin dhe përdorimin e rezultateve
Gjithëpërfshirja	<ul style="list-style-type: none"> - Çështjet gjinore - Respektimi i nxënësve me nevoja të veçanta - Respektimi i nevojave të monitoruesve - Respektimi i nevojave të ndryshme socio-ekonomike - Njohuri mbi heterogjenitetin dhe se si t'i përgjigjemi atij në një mënyrë pozitive dhe efektive
Menaxhimi i ndërtesave të shkollës	<ul style="list-style-type: none"> - Menaxhimi i oborreve të shkollës - Menaxhimi i ndërtesave të shkollës - Asetet e jashtme të shkollës - Njohuri mbi nevojat për një shkollë të shëndetshme - Klasat dhe materialet për mësimdhënie - Kabinetet, punëtoritë dhe laboratorët.

Aktivitet # 1:

- Ju lutem shikoni listën e treguesve. Nëse mungon një tregues i rëndësishëm, ju lutem shtojeni atë.
- Cili nga treguesit në faqet 10 & 11 mendoni se janë më të rëndësishmit për të formuar një shkollë të mirë?
- Në cilin nga treguesit mendoni se shkolla juaj aktualisht performon mirë? Ne cilët nga treguesit (zgjidhni deri në 5) mendoni se shkolla juaj mund të përmirësohet. Ju lutem shënoni ata. Disa nga fushat e cekura për cilësinë do të adresohen në detaje në seminarët tjera. Ky seminar përqendrohet në kulturën e mësimnxënies, kulturën e shkollës, gjithëpërfshirjen dhe standardet për një Shkollë Mike për Fëmijë.

Komente:

Kultura e shkollës thjesht përshkruhet si “mënyra se si jetojmë këtu”. Kultura e shkollës caktohet nga një numër faktorësh. Një faktor i domethënës është se si fëmijët (nxënësit) ndjehen për shkollën e tyre. A e mirëpresin nxënësit ardhjen në shkollë për çdo ditë? Hulumtimet e fundit²⁰ në Kosovë treguan një fakt alarmues: rreth 60% e nxënësve nuk ndihen të sigurt në shkollë, prindërit poashtu kanë këtë mendim. Madje edhe mësimdhënësit ankohen për mungesën e sigurisë.

Shkollat duhet të jenë vende ku nxënësit dëshirojnë të jenë. Bëje shkollën atraktive, mbaj fëmijët e interesuar, mësoi ata mirë, menaxho sjelljet në mjedisin e shkollës ashtu që nxënësit të jenë të sigurt dhe përfshini komunitetin me një plan me aktivitete jashtë kurrikulës. Përforsimi i “gjithëpërfshirjes” në sistemin arsimor është një prioritet i MASHT-it. Çka nënkuptojmë me gjithëpërfshirje? Si mund të thoni se shkolla juaj është një shkollë gjithëpërfshirëse?

Lista në faqet 10 & 11 përfshin karakteristika për **një shkollë të mirë** të thëna nga hulumtuesit nga mbarë bota.²¹ Të gjithë pajtohen: një shkollë e mirë ka nevojë për një koncept të qartë të arsimit me udhëheqje kompetente dhe filozofi pedagogjike koherente. Shkolla me një profil të fokusuar në cilësi që realizohet nga stafi ka një përparësi të qartë dhe arrijnë rezultate më të mira. Dy studime të ndryshme nga viti 2009 tregojnë rëndësinë e mësimdhënësve për të pasur një shkollë të mirë, të suksesshme (Hattie, 2009²² dhe Helmke²³, 2009).

2.2. Kultura e mësimdhënies dhe nxënies

Bazë për kulturë të mësimdhënies dhe nxënies është njohuria profesionale cilësore dhe praktika e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Rezultatet e reja shkencore për trurin e njeriut japin një të kuptuar se si shfaqet mësimnxënia dhe çka duhet të konsiderohet gjatë mësimdhënies. Kjo njohuri po ndryshon, prandaj mësimdhënësit duhet të rifreskojnë vazhdimisht njohuritë dhe shkathhtësitë e tyre profesionale sa i përket mësimdhënies dhe mësimnxënies duke u bazuar në hulumtime të caktuara.

Në mënyrë që të krijojmë një kulturë të mësimnxënies, është e rëndësishme që performanca e secilit mësimdhënës të përmirësohet sa i përket objektivave të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës. Kjo bazohet pjesërisht në atë se çka fëmijët mësojnë më së miri. Si shtesë, shkolla mund të ndihmojë që të bëjë përvojën në shkollë dhe mësimnxënien më atraktive dhe praktike përmes një kurrikule kreative shkollore, kurrikulë e cila iu ofron studentëve më shumë mundësi të studiojnë lëndët që janë të lidhura me nevojat e tregut në rrethinën ku ata jetojnë, urbane apo rurale. Kultura e mësimnxënies mund të avancohet edhe më tej nëse sistemi arsimor ofron

20 Hulumtimi në kënaqësinë, IQ-consult, Prishtinë, 2011

21 Si p.sh. Brookover 1979, Aurin 1991, Steffens & Bargel 1993, Gray & Wilcox 1995, Altrichter & Posch 1997, Fend 1998

22 John Hattie, 2009 në: Prof. Dr. Olaf Köller: MNU-Herbsttagung des Landesverbandes S-H, Kiel, 22.09.2010

23 Helmke, Andreas 2009: Unterrichtsqualität und Lehrerprofessionalität. Diagnose, Evaluation und Verbesserung des Unterrichts. Kallmeyer in Verbindung mit Klett.

arsimin joformal (ose i bazuar në shkathtësi) për ata që e braktisin shkollën herët, si shkathtësitë teknike të lidhura për punën.

2.2.1. Shkollave iu duhet mësimdhënie e cilësisë së lartë për të qenë të mira!

Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies është shumë i rëndësishëm për të pasur një shkollë të mirë. Në studime të ndryshme ndërkombëtare roli i mësimdhënësve është element qendror për të arritur rezultate të mira, të arritura të suksesshme, të cilat janë elemente të rëndësishme për një shkollë të mirë.

Helmke hulumtoi faktorët për mësimdhënie dhe mësimnxënie të suksesshme. Rezultatet e studimit të tij kryesor ishin 10 fusha të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe pra 10 faktorë për një shkollë të mirë:

1. menaxhimi i klasës
2. qartësia dhe struktura e mësimdhënies
3. ruajtja dhe konsolidimi
4. aktiviteti i nxënësve
5. motivimi
6. klimë përkrahëse në klasë
7. fokusim në secilin nxënës
8. fokusim në kompetenca
9. adresimi i heterogjenitetit
10. ofrimi i mjediseve të ndryshme arsimore dhe aranzhimeve mësimore

Menaxhimi i klasës nënkupton jo vetëm 'menaxhimin' e sjelljes, por mësimdhënësin duke performuar si planifikues lëndor, monitorues i mësimnxënies, këshilltar dhe përkrahës. Ai ose ajo është përgjegjës për të parë që secili nxënës ka të drejtën të mësojnë në një orë mësimore. Menaxhimi i klasës poashtu nënkupton përdorimin efektiv të kohës në një orë mësimore dhe si të mënjanohen pakënaqësitë.

Qartësia dhe struktura e mësimdhënies nënkupton se si mësimdhënësit paraqesin dhe mësojnë përmbajtjet dhe si ata i strukturojnë mësimet e tyre, që të lehtësojnë procesin e mësimnxënies për nxënësit.

Ruajtja dhe konsolidimi përshkruajnë nevojën e sigurimit të ushtrimeve efektive të mësimnxënies.

Aktiviteti i nxënësve ndërlidhet me atë se çfarë u thotë mësimdhënësi të bëjnë nxënësit (aktivitetet) për të arritur objektivat e orës mësimore sa i përket: zhvillimit kognitiv, shoqëror, fizik, dhe praktik. Vet-veprimi (vet-drejtimi) i nxënësve, format bashkëpunuese dhe metodat e mësimnxënies, mjedisi mësimor, reflektimi për mësimnxënien janë disa nga aktivitetet e nxënësve.

Motivimi si faktor kryesor për mësimnxënie aktive nënkupton që detyrat të jenë sfiduese dhe të rrisin kureshtjen e nxënësve. Për më tepër nxënësit duhet ta kontrollojnë procesin e tyre të mësimnxënies dhe duhet të angazhohen në fantazi dhe kreativitet. Motivimi ka nevojë edhe për transparencën edhe për cilësinë e pritjeve të mësimdhënësve.

Klima përkrahëse në klasë nënkupton kulturën e mësimnxënies në klasë duke përfshirë nivelin e kënaqësisë së nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve me procesin e mësimnxënies dhe rezultatet. Trajtimi i gabimeve në mënyrë pozitive dhe efektive është element domethënës për një klimë përkrahëse në klasë.

Fokusimi në secilin nxënës nënkupton se i tërë procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies duhet t'iu përshtatet nxënësve, moshës së tyre, nivelit të zhvillimit dhe njohurive, rrethit dhe interesave. Për përgatitjen e planeve mësimore është e nevojshme që mësimdhënësit të dinë shumë për nxënësit e tyre në mënyrë që t'i motivojnë dhe aktivizojnë ata. Prandaj, informata kthyesë nga nxënësit e tyre iu ndihmon shumë mësimdhënësve rreth mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Fokusimi në kompetenca nënkupton që të arrihen standardet ndërkombëtare dhe kombëtare të arsimit, janë objektivat e mësimdhënies. E tërë kurrikula e shkollës është e organizuar në standardet e kompetencave, të cilat mund të testohen dhe vlerësohen.

Adresimi i heterogjenitetit bëhet më gjithnjë më shumë fokusim i caktuar në shkollë. Heterogjeniteti dhe individualiteti janë elemente normale të shoqërive. Zakonisht në shumë shkollë, gjenden nxënës me sfond shoqëror dhe kulturor, religjion, gjuhë amtare, gjini etj. të ndryshme. Prandaj është e nevojshme që të individualizohet procesi i mësimdhënies.

Ofrimi i mjediseve të ndryshme mësimore dhe aranzhimeve mësimore me lloje të ndryshme të mësimdhënies janë rezultat i adresimit efektiv të heterogjenitetit dhe individualitetit. Nga studimet specifike dimë se mësimnxënja është një proces vet-veprues i secilit person, ajo ka nevojë për qëllime, aktivitete, përvoja, motivim dhe reflektim. Mësimdhënësit provojnë të bëjnë mjedise të tilla ku nxënësit mësojnë aktivitete të drejtuara vet, dhe angazhohen në vet-reflektim dhe vet-përgjigje.

Në mënyrë që të realizojmë dhe arrijmë këta faktorë për mësimdhënie dhe mësimnxënie të mirë është e nevojshme të kualifikohen mësimdhënësit. Roli i mësimdhënësit në Kosovë ka ndryshuar në pak vitet e fundit. Nëse një shkollë dëshiron të bëhet e mirë dhe e suksesshme ka nevojë për mësimdhënës profesional që veprojnë si këshilltar, trajnues dhe monitorues të mësimnxënies së nxënësve. Ky është poashtu rezultati i një studimi të John Hattie, 2009. Mësimdhënësit janë faktori më domethënës për një shkollë të mirë dhe për një arsim cilësor.

2.3. Gjithëpërfshirja

Në secilën shoqëri sektori i arsimit duhet të kujdeset për të gjithë fëmijët. Përderisa shumica e fëmijëve normalisht shkojnë në shkollë, janë disa grupe fëmijësh të cilët janë në rrezik për përjashtim. Në shumë shtete kjo vlen për fëmijët e grupeve të ndryshme gjuhësore dhe minoritetet etnike, nga rrethinat e largëta në fshatra, deri tek fëmijët nga familje të varfra ekonomikisht dhe fëmijët me nevoja të veçanta. Mosbarazia gjinore është një çështje që lidhet me secilin lloj të jofavorizimit arsimor.

Gjithëpërfshirja nuk është vetëm për ata fëmijë që nuk shkojnë në shkollë – por poashtu për ata fëmijë që regjistrohen në shkollë, por nuk e përfundojnë të tërë ciklin e arsimit fillor dhe mund të mos kenë arsim të cilësisë së mirë. Kështu fëmijë në rrezik janë poashtu ata fëmijë që e kanë braktisur shkollën herët dhe kanë nevojë për një mundësi të dytë të arsimit: Arsimi duhet të jetë i hapur për secilin, duhet të jetë gjithëpërfshirës.

Sipas UNESCO-s Gjithëpërfshirja definohe si proces i adresimit dhe përgjigjes ndaj llojllojshmërisë së të gjithë nxënësve duke ngritur pjesëmarrjen në mësimnxënie, kultura dhe komunitete, dhe duke zvogëluar përjashtimin

Që të arrihet tek ata “të cilët janë vështirë për tu arritur,” nevojiten ndryshime dhe modifikime në përmbajtje, qasje, strukturë dhe strategji. Nevojitet bindje dhe një vizion i përbashkët që përfshin të gjithë fëmijët e moshës adekuate; ajo është përgjegjësia e sistemit të rregullt që të arsimojë të gjithë fëmijët. (UNESCO, 2005:13)

Sistemi arsimor që është gjithëpërfshirës nuk duhet të shikohet si “luksoz”: sepse “çmimi” që shoqëria paguan nëse fëmijët lihen sistematikisht jashtë sistemit arsimor në fund është shumë më i lartë se sa harmonizimi rreth gjithëpërfshirjes nga fillimi. Kushton më shumë t’i arrijë ata përsëri pasiqë të jenë rritur sepse nevojitet më shumë mund dhe resurse.

Prandaj ndalimi ndaj ikjes prej orëve të mësimit në shkollë dhe braktisja e hershme duhet të merren shumë seriozisht. Fëmijët normalisht nuk e braktisin shkollën vetëm ashtu “në ditë pa re:” ka shenja që tregojnë se fëmija është në stres, se problemet po rriten dhe të cilat në fund mund të shpijnë tek vendimi për të braktisur shkollën. MASHT-i në bashkëpunim me GTZ-në ka zhvilluar një doracak trajnues kundër braktisjes së shkollës, i cili është një mjet shumë i rëndësishëm për secilin mësues të cilin dëshiron t’i përballojë sfidat e arsimit të të gjithë fëmijëve.

Gjithëpërfshirja është një çështje që kalon nga edukimi para-shkollor deri te arsimi i mesëm. Çështjet e gjithëpërfshirjes janë renditur në kutinë 1.

Kutia 1 Aspektet kryesore të barazisë dhe gjithëpërfshirjes në nivelin e shkollës

- Njohja e të drejtës së nxënësve në arsim në lokalitetin e tyre, në ofrim të rregullt bashkë me moshatarët e tyre;
- Fokusi në atë që fëmijët e kanë të përbashkët – dhe jo në atë që i dallon;
- Mjedis mësuesor i qasshëm, i sigurt dhe mikpritës për fëmijën;
- Përkrahja për arsimin në kopsht dhe atë para-shkollor;
- Vlerësimi i të gjithë nxënësve dhe stafit në mënyrë të barabartë;
- Rritja e pjesëmarrjes së nxënësve, prindërve dhe komunitetit;
- Zvogëlimi i përjashtimit të nxënësve nga mundësitë për mësim në shkollë dhe më tej;
- Përgjigja ndaj diversitetit të nxënësve në lokalitet;
- Zvogëlimi i pengesave ndaj mësimit dhe pjesëmarrjes për të gjithë nxënësit, dhe të mësuarit nga përpjekjet për të tejkaluar ato pengesa për të bërë ndryshime për të mirën e të gjithë nxënësve;
- Sigurimin e arritshmërisë, dhe avancimin e aftësive të të gjithë nxënësve.
- Përmirësimi i shkollave për stafin e poashtu edhe për nxënësit;
- Nxitja e marrëdhënieve reciprokisht të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse mes shkollave dhe komuniteteve; (Përshtatur/zhvilluar nga *Indeksi i Gjithëpërfshirjes*, Booth et al, 2002).

Aktivitet # 2: Adresimi i gjithëpërfshirjes në shkollën tuaj:

1. Cilët fëmijë ende nuk janë regjistruar në shkollë apo nuk kanë përfunduar shkollën fillore? Rendisni këtë, duke u bazuar në të dhënat në dispozicion për regjistrim, dhe ngelje në klasë. Kërkoni disa mekanizma më bazë në shkollë dhe komunitet për të mbledhur informacione lokale për fëmijët që nuk janë në shkollë/ apo vijueshmëria e tyre është jo e rregullt.
2. Cilët janë faktorët kryesorë që ndikojnë në regjistrimin dhe përfundimin e shkollës nga fëmijë të caktuar?
Analizimi i pengesave mund të ndihmojë në identifikimin e atyre faktorëve që kanë më së shumti gjasa të ndikojnë në pjesëmarrjen dhe në përfundimin e shkollës për grupe të ndryshme të fëmijëve, veçanërisht ata që identifikohen se janë në rrezik të veçantë që të mos vijojnë ose përfundojnë shkollën.
Analiza e të dhënave të SMIA-s dhe anketimeve të shtëpive mund të tregojë pengesat e veçanta.
3. Cilat politika janë në funksion aktualisht në ndërlidhje me barazinë, gjithëpërfshirjen dhe arsimin? Përkrahja për shkollat do të mund të përfshinte qendrat burimore, mësuesit mbështetës apo mësuesit asistent, punëtorët socialë në shkollë, përfshirja dhe përkrahja e prindërve, shërbimet për këshillimin e nxënësve dhe grantet për të përmirësuar ndërtesat/objektet, p.sh. të bëhen ndërtesat më të qasshme. Cilat forma të përkrahjes janë tashmë në funksion/apo do të mund të zhvilloheshin më tutje? Çfarë lloj përkrahje vendore ofrohet për shkollat për t’i ndihmuar ato të bëhen me gjithëpërfshirëse?

2.4. Kultura shkollore

2.4.1. Aktivitetet jashtë-kurrikulare

Për të plotësuar kurrikulën formale dhe për ta bërë shkollën më tërheqëse, aktivitetet jashtëkurrikulare janë mënyra më e mirë që nxënësit dhe prindërit të mbahen afër shkollës. Aktivitetet jashtë-kurrikulare variojnë nga përkrahja individuale për nxënësit deri tek sportet, muzika, etj.

Shembuj:

1. Përkrahja për nxënësit që kanë rezultate të dobëta
2. Shkathtësitë jetësore
3. Klube për lëndë të ndryshme dhe interesa të nxënësve (ku përdoren metoda të mësimdhënies që janë pjesëmarrëse, me nxënësin në qendër dhe të respektueshme ndaj gjinive)
4. Puna grupore me nxënësit në shkolla (klubet, udhëheqja e shkollës);
5. Integrimi i fëmijëve në klasat plotësuese të organizuara nga të tjerët (OJQ-të, agjencitë arsimore)
6. Nxënësit që zhvillojnë mjedise shkollore dhe materiale mësimore për të plotësuar nevojat e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Për shumë fëmijë, aktivitetet jashtë-kurrikulare paraqesin mundësi për të praktikuar shkathtësi sociale dhe për të eksperimentuar në aktivitete që mund të përfaqësojnë interesime për karriera të ndryshme. Për një nxënës që nuk është i talentuar në aspektin akademik, mundësia për të shkëlqyer në arte apo sporte mund të ketë ndikim të madh në **vetërespektin** e tij/saj. Për më tepër, ne e dimë nga studimet ndërkombëtare se aktivitetet jashtë-kurrikulare janë të nevojshme për **vetëbesim**, i cili është i rëndësishëm për mësimin më të mirë dhe suksesin në provime dhe në jetë. Për më tepër mund të mësojmë më mirë nëse janë aktive të dy anët e trurit. Për shembull ekziston korrelacioni mes muzikës dhe matematikës dhe mes kreativitetit dhe gjetjes së zgjidhjeve për probleme. Një shembull tjetër nga biznesi na tregon se: Sot menaxherët nuk duhet të kenë vetëm njohuri lidhur me menaxhimin e një çështje apo një kompanie, por poashtu edhe kompetenca emocionale, personale dhe sociale për udhëheqje. Fatkeqësisht shumë shkolla nuk krijojnë mundësi për nxënësit që të zhvillojnë kompetenca të tilla të rëndësishme. Njohuritë kognitive nuk janë të mjaftueshme në një botë ku njohuritë (informatat) vjetrohen brenda një kohe të shkurtë.

Në mënyrë që të përkrahen aktivitetet jashtë-kurrikulare dhe të përkrahet secili nxënës, është e dobishme të krijohen shkolla me orar të plotë, ku nxënësit kanë kohë për mësim dhe për zhvillimin e kompetencave të tyre dhe mësimdhënësit kanë kohë të mësojnë personalitetin e plotë dhe karakterin e secilit nxënës.

2.5. Rregullat e shkollës dhe kultura shkollore

Ligji për arsimin parauniversitar në Kosovë (2011) parasheh hartimin e rregulloreve të shkollës që udhëheqin sjelljen e nxënësve. Shkolla poashtu mund të hartojë rregullore shtesë për të mirën e organizmit më të mirë të mësimin, si:

- Rregullorja për vijueshmërinë e nxënësve
- Rregullorja mbi komunikimin me prindër dhe përfshirjen e prindërve;
- Rregullorja mbi praktikën e stafit;
- Rregullore për përdorimin efektiv të të dhënave arsimore që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të shkollës, etj.

Sjellja e nxënësve më së miri menaxhohet përmes politikave shkollore të dizajnuara mirë.

Hartimi i rregullave të sjelljes në shkollë kërkon angazhim të akterëve të shumtë, jo vetëm të mësimitdhënësve dhe udhëheqësve të shkollës. Pyetjet e para dhe të një rëndësie kritike në të cilat duhet të jipet përgjigje para hartimit të rregullave të shkollës janë: Pse na duhen rregullat e sjelljes në shkollë? Cili është qëllimi i rregullave të sjelljes? Si duhet të hartohen rregullat e sjelljes në shkollë (p.sh. procesi që duhet të aplikohet)? Kush duhet të përfshihet në hartimin e rregullave të sjelljes në shkollë? Si do të komunikohen rregullat e shkollës tek mësimitdhënësit dhe nxënësit? Si do të reflektohen rregullat e sjelljes në shkollë? Si do të monitorohet zbatimi i rregullave të sjelljes?

Përgjigjet në këto pyetje na shpijnë tek qëndrimi që shkollat duhet të përfshijnë akterë të ndryshëm në hartimin e rregullave të sjelljes në shkollë: qëllimet e rregullave të sjelljes duhet të jenë të qarta; ato duhet të jenë të arritshme, dhe duhet të monitorohet zbatimi i tyre.

Përmes rregullave të sjelljes në shkollë ne qartësojmë pritjet se si nxënësit, mësimitdhënësit dhe personat tjerë në shkollë duhet të sillen, komunikojnë dhe bashkëveprojnë me njëri tjetrin.

2.5.1. Qëllimet e rregullave të sjelljes në shkollë

Qëllimi i bërjes së rregullave të shkollës është të eliminohet konflikti brenda shkollës. Ato ekzistojnë për të siguruar se çdo nxënës mund ta ushtrojë të drejtën për të mësuar.



Shmangni konfliktet me rregullat

- Rregulloni atmosferën ku është e mundshme mësimitdhënia dhe mësimitnxënia
- Rregulloni bashkekzistencën e nxënësve dhe mësimitdhënësve në shkollë
- Siguroni kriteret e qarta për mirësjelljen
- Siguroni drejtësi që është në harmoni me ligjet dhe politikatat arsimore
- Bëjeni të qartë për të gjithë çfarë pritet prej nxënësve

Procesi i hartimit të rregullave të shkollës

Rregullat e shkollës duhet të hartohen ashtuqë të jenë në pajtim me ligjin. Drejtori i shkollës është përgjegjës për fillimin e procesit të zhvillimit të rregullave të shkollës. Pyetjet kryesore (nga faqja e mëparshme) udhëheqin procesin e hartimit të rregullave të shkollës. Përgjigjet:

- Përcaktojnë qëllimin e rregullave; d.m.th. rezultatet e parapara të tyre;
- Identifikojnë se kush duhet të konsultohet dhe kush duhet të përfshihet në zhvillimin e rregullave të shkollës;
- Identifikojnë procesin për angazhimin e palëve të interesuara dhe për zhvillimin e rregullave;
- Identifikojnë se kush është e ka autoritetin përfundimtar për miratimin e rregullave të shkollës (Këshilli Drejtues i Shkollës dhe DKA);
- Identifikojnë se si do të komunikohen rregullat tek nxënësit, mësimitdhënësit dhe prindërit;
- Identifikojnë se si do të monitorohen rregullat dhe çfarë lloj shënimesh duhet të mbahen sa i përket shkeljes së rregullave.

Nuk është e mundur të krijohen rregulla për secilin situatë. Rregullat do të duhej të bazoheshin në parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me detyrat e shkollës për të siguruar arsim cilësor. Drejtorët e shkollave dhe mësime të mësimdhënësit janë përgjegjës për mësimin efektiv dhe të suksesshëm. Secili nxënës ka të drejtë në arsim në një atmosferë besimplotë, të sigurtë, miqësore dhe të respektueshme. Prandaj të gjithë akterët kryesor të shkollës duhet të mendojnë për rolin e tyre për të arritur një kulturë të tillë shkollore, ku mësime të mësimdhënësia e mësime të mësimdhënësia mund të ndodh pa shqetësime të paarsyeshme ose dhunë.

Për shembull një element i rëndësishëm për mësime të mësimdhënësia e mësime të mësimdhënësia është se orët e mësimit fillojnë me kohë. Nëse nxënësit vijnë me vonesë është e rëndësishme të dihen arsyt pse ndodh ashtu. Ndoshta ata kanë linjë të keqe të autobusit apo kanë rrugë të gjatë mes klasave/shkollave të ndryshme. Disa arsye mund të korrigjohen nga mësime të mësimdhënësia. Dhe nëse mësime të mësimdhënësia shpesh nuk janë të përpiktë në orar, është e nevojshme të dihen arsyt e tyre. Por nëse nuk ka arsye të mira për këto drejtori i shkollës duhet ta korrigjoj këtë sjellje joprofesionale të personelit të tij/saj.

Ky shembull tregon se pse është e rëndësishme të diskutohen kushtet që janë të rëndësishme për nxënësit, mësime të mësimdhënësia dhe drejtorin e shkollës në mënyrë që të krijohet një shkollë e mire me arsim cilësor.

Ky shembull do të shpinte në krijimin e një rregulli si: "Orët e mësimit fillojnë në kohën e saktë, sepse nxënësit dhe mësime të mësimdhënësia kanë të drejtë ta shfrytëzojnë kohën e tyre në mënyrë efektive."

Në aspektin psikologjik është me rëndësi të **formulohen rregullat në mënyrë pozitive**.

Shembulli i shkollës së mirë: Një shkollë e mire ka një sistem gjithëpërfshirës të **kujdesit** për nxënësit. Kjo shprehet në rregullat e sjelljes, të cilat hartohen në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për të gjithë. Në parim, respekti për njëri tjetrin vendoset në qendër, pastaj respekti për kulturat tjera, parandalimin e abuzimeve, fyerjeve të ndryshme dhe akteve të dhunës, etj. Formulimi i rregullave të shkollës së mirë mund të shprehet në këtë mënyrë: "Të gjithë fëmijët tonë, përkundër dallimeve të tyre, pranohen dhe respektohen njëjtë nga të gjithë në shkollë, nxënësit lirisht mund të shprehin mendimet e tyre; nuk pengohet mësimi i asnjë nxënësi, etj..."

Nuk këshillohet krijimi i një liste me dënime të caktuara sepse shkolla duhet të jetë në gjendje të përgjigjet në një mënyrë e cila e korrigjon sjelljen. Shpesh përdoret krijimi i një vargu të pasojave. Kur sjellja e një nxënësi e rrezikon sigurinë e personave të tjerë, mësime të mësimdhënësia dhe drejtorët e shkollave duhet të reagojnë në pajtim me ligjin.

Kur rregullat e shkollës krijohen nga të gjithë dhe vendosen në formë të shkruar, atëherë:

- a. Të gjithë anëtarët e shkollës dhe prindërit informohen lidhur me rregullat e shkollës.
- b. Çdo ndryshim në rregullat e shkollës komunikohet tek të gjithë.
- c. Rregullat shkollore qartësohen me kujdes dhe mirësjellje veçanërisht për të rinjtë
- d. Rregullat e shkollës ekspozohen publikisht
- e. Rregullat e shkollës dërgohen me shkrim tek secili nxënës (i ri), prindërit dhe mësime të mësimdhënësia

Shumë shkolla kanë rregulla por zbatohen vetëm disa prej tyre. A është kjo e drejtë?

3. Standardet për shkollat mike për fëmijë

Cilat janë standardet për shkollat mike për fëmijë dhe cili është qëllimi i tyre?

Standardet për shkollat mike për fëmijë ndërlidhen ngushtë me standardet e praktikës profesionale për shkollën, por ato shtrihen edhe me gjerë sepse ato përcaktojnë gjithçka që akterët arsimor duhet të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë me theks të veçantë tek të gjithë përfaqësuesit e shkollës për të përmirësuar cilësinë e mësimnxënies për të gjithë nxënësit.


Standardet për shkollat mike për fëmijë shërbejnë si udhëzim për adresimin e çështjeve të ndryshme si: të drejtat e fëmijëve, shëndeti dhe mirëqenia, barazia gjinore, gjithëpërfshirja, pjesëmarrja aktive në jetën shkollore dhe në procesin e mësimnxënies, etj., për të matur cilësinë dhe për të vlerësuar performancën e shkollës.



Qëllimi – Standardet për shkollat mike për fëmijë janë hartuar për të: (1) përfshirë dhe integruar në një dokument të gjithë komponentët e treguesve të cilësisë në arsim që ndikojnë në bërjen e shkollave mike për fëmijë, dhe (2) për të përcaktuar matjen e kërkesave për të ndihmuar shkollat dhe institucionet arsimore të vlerësojnë dhe vetë-vlerësojnë punën e shkollës në mënyrë që të ndërmerren masa relevante që rrisin pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve në jetën shkollore dhe procesin mësimor.


Struktura dhe organizimi i standardeve për shkollat mike për fëmijë

Filozofia e Shkollave Mike për Fëmijë (ShMF) bazohet në tri parime kryesore (i) fëmija në qendër, (ii) gjithëpërfshirja dhe (iii) pjesëmarrja demokratike. Duke u bazuar në këto parime dhe kontekstin e shtetit në të cilin vendosen standardet e ShMF, përcaktohen dimensionet, dhe pastaj elaborohen fushat/temat, ku adresohen treguesit për standardet e secilit dimension.



Dimensionet, standardet dhe treguesit përcaktohen varësisht nga nevojat e shoqërisë që e bazon filozofinë arsimore në shkollat mike për fëmijë. Në rastin e Kosovës, standardet organizohen në gjashtë dimensione: (i) gjithëpërfshirja; (ii) efektiviteti i mësimdhënies e mësimnxënies; (iii) shëndeti, mjedisi dhe siguria; (iv) pjesëmarrja demokratike; (v) barazia gjinore; dhe (vi) diversiteti kulturor.

Skemë: Dimensionet e Standardeve të ShMF



Në dokumentin për standardet e ShMF, jipet një përkufizim për secilin dimension, që është baza për hartimin e standardeve të dimensioneve, dhe pastaj duke u bazuar në standarde, përcaktohen treguesit, dhe duke u bazuar në to shkollat dhe institucionet arsimore pritët ta vlerësojnë dhe vetë-vlerësojnë performancën e shkollës.

Komponentët shkollor, janë një element i rëndësishëm i strukturës së Standardeve të ShMF. Ato janë elementet kryesore të strukturës dhe organizimit të punës së shkollës dhe ndahen në tre komponentë kryesor: (i) menaxhimi dhe udhëheqja, (ii) kapacitetet e shkollës, dhe (iii) procesi i kurrikulës, mësimdhënies e mësimnxënies.

- Komponenti Menaxhimi dhe Udhëheqja përfshin treguesit që masin dhe vlerësojnë punën e personelit të menaxhimit të shkollës, duke përfshirë: përmbajtjen e dokumenteve të shkruara në shkollë, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit, detyrat që janë përgjegjësi e drejtorit, detyrat që janë përgjegjësi e këshillit udhëheqës të shkollës, e poashtu edhe detyrat që janë përgjegjësi e këshillit të prindërve dhe këshillit të nxënësve;
- Komponenti Kapacitetet Shkollore përfshin tregues që masin dhe vlerësojnë aspektet e ndërlidhura me: përgjegjësitë e mësimdhënësve, përgjegjësitë e nxënësve, përgjegjësitë e shërbimit profesional, gjendjen fizike të shkollës (oborri, ndërtesa shkollore, korridoret, dhe hapësirat tjera)
- Komponenti Procesi i kurrikulës dhe mësimdhënies e mësimnxënies përfshin tregues që masin dhe vlerësojnë kurrikulën, metodat e mësimdhënies, disponueshmërinë e resurseve mësimore, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit/përdorimi i kompjuterëve, mjetet mësimore në klasë, organizimi dhe zbatimi i aktiviteteve jashtë-kurrikulare, relacionet e mësimdhënësve jashtë klasës (në aktivitetet jashtë-kurrikulare).

Dimensionet e standardeve të ShMF: Efektiviteti i mësimdhënies dhe mësimnxënies²⁴**Përkufizim:**

Mësimdhënia me nxënësin në qendër merr parasysh aftësitë, nevojat dhe interesat e nxënësve dhe respekton stilet e nxënies së secilit nxënës që të zhvillojnë plotësisht potencialet e tyre në pajtim me kërkesat e kurrikulës (shoqërisë) dhe për të aftësuar nxënësit të bëhen qytetarë aktiv dhe të jenë në gjendje të përballen me sfidat e jetës. Efektiviteti i mësimdhënies arrihet përmes zbatimit të strategjive dhe teknikave të mësimdhënies që reflektojnë bashkëveprimin gjatë procesit mësimor dhe që kërkon aftësimin profesional të mësimdhënësve për arritjen e kompetencave.

Ushtrimi 1: Në grupe të vogla, analizoni secilin tregues të standardeve të dimensionit Efektiviteti i mësimdhënies e mësimnxënies dhe bëni një vlerësim të arritshmërisë duke u bazuar në listat e treguesve dhe kritereve si në vijim:

- Për treguesit që janë arritur plotësisht, shënoni √
- Për treguesit që janë arritur pjesërisht, shënoni ≈
- Për treguesit që nuk janë arritur fare, shënoni X

Standardi 1: Të gjithë nxënësit angazhohen aktivisht në procesin mësimor dhe mbështeten në zhvillimin e potencialit të tyre.

	Treguesit	
Menaxhimi dhe udhëheqja	1.1. Shkolla ka krijuar një sistem të rregullt dhe me kohë të informimit për prindërit mbi pjesëmarrjen e fëmijëve në procesin mësimor dhe mbi rezultatet e arritura.	√, ≈, X
	1.2. Shkolla ka hartuar planin për zhvillimin profesional dhe ka siguruar përfshirjen e mësimdhënësve në programin trajnues mbi metodologjitë e mësimdhënies që mundësojnë angazhim aktiv të të gjithë nxënësve në procesin mësimor.	
	1.3. Shkolla ka procedura dhe instrumente për gjithëpërfshirje të të gjithë faktorëve relevant në hartimin e kurrikulës me bazë shkolle, varësisht nga nevojat e nxënësve dhe kërkesat e komunitetit.	
	1.4. Shkolla ka planifikuar dhe siguruar me kohë resurse të mjaftueshme për zbatimin e aktiviteteve të mësimdhënies e mësimnxënies për nxënës.	

²⁴ Pasi që ky seminar mbulon mësimdhënien dhe të nxënësve, si dhe dhe aftësimin profesional të mësimdhënësve, në vijim ne do të diskutojmë vetëm dimensionet e standardeve të ShMF: Efektiviteti i mësimdhënies dhe nxënies.

Kapaciteti shkollorë	1.5. Interesat e nxënësve adresohen në mënyrë të duhur nga orari mësimor i hartuar me kohë nga shkolla	
	1.6. Të gjitha nxënësit kanë qasje në kurrikulë, programe ndër-kurrikulare dhe jashtë-kurrikulare.	
	1.7. Shkolla ka fusha të nevojshme specifike dhe funksionale që pajisen me resurse adekuata sipas nevojave mësimore.	
	1.8. Shkolla përdor hapësirën në dispozicion, mjetet dhe resurset e mësimdhënies në mënyrë të balancuar për të gjitha lëndët dhe klasat për të zbatuar aktivitetet kurrikulare dhe jashtë-kurrikulare.	
	1.9. Shkolla krijon mjete mësimore dhe resurse tjera përkrahëse për nevojat e mësimdhënies efektive.	
	1.10. Zhvillimi i nxënësve mbështetet nga shërbimet profesionale që i siguron shkolla përmes bashkëpunimit ndër-institucional.	
	1.11. Kërkesat e nxënësve për mësim shtesë dhe nevoja për mësim plotësues parashikohen në planin e punës së shkollës dhe zbatohen sipas nevojave të nxënësve dhe afateve të përcaktuara kohore.	
Procesi i kurrikulës dhe mësimdhënies e mësimnxënies	1.12. Arritshmëria e nxënësve monitorohet dhe vlerësohet sistematikisht nga mësimdhënësit.	
	1.13. Aktivitetet e nxënësve të zbatuara nga mësimdhënësit nxisin bashkëveprimin gjatë procesit të mësimnxënies.	
	1.14. Nxënësit motivohen në forma të ndryshme nga mësimdhënësit për pjesëmarrje aktive në aktivitetet mësimore dhe jashtë-kurrikulare	
	1.15. Nxënësit dhe prindërit informohen rregullisht nga mësimdhënësit mbi arritshmërinë e rezultateve mësimore nga nxënësit	
	1.16. Nxënësit mësojnë në pajtim me stilet e tyre të mësimnxënies, që mundësohet përmes mësimdhënies.	
	1.17. Nxënësit nxiten nga mësimdhënësit përmes formave dhe metodave të ndryshme që të mendojnë e veprojnë në mënyrë të pavarur.	
	1.18. Puna e nxënësve mbështetet nga shkolla për publikimin brenda dhe jashtë shkollës.	

Standardi 2: Mundësitë, nevojat dhe interesat e nxënësve gjatë procesit mësimor janë në fokus të mësimdhënies që zbatohet me metodologji të ndryshme

Komponentët shkollorë	Treguesit	√, ≈, X
Menaxhimi dhe udhëheqja	2.1. Shkolla ka mekanizma për monitorimin e zbatimit të metodologjive të mësimdhënies që marrin parasysh aftësitë, nevojat dhe interesat e nxënësve.	
	2.2. Shkolla ka procedura dhe i zbaton ato për vetë-vlerësimin e punës së shkollës.	
	2.3. Shkolla ka procedura dhe i zbaton ato për themelimin dhe funksionimin e organeve udhëheqëse dhe profesionale brenda shkollës, siç janë: këshilli udhëheqës i shkollës, departamentet profesionale, këshillat e klasave dhe organe tjera udhëheqëse e profesionale në shkollë.	
	2.4. Shkolla siguron informata të rregullta dhe gjithëpërfshirëse për punën e shkollës për autoritetet kompetente.	
Kapacitetet shkollorë	2.5. Shkolla ka dhe përcjell literaturën aktuale profesionale të larmishme dhe ka resurse përkrahëse për mësimnxënie që ndihmojnë në zbatimin e metodologjive të mësimdhënies që marrin parasysh aftësitë, nevojat dhe interesat e nxënësve.	
	2.6. Shkolla ofron internetin, TIK, dhe shërbime tjera teknologjike për nevojat e mësimdhënies e mësimnxënies në shkollë.	
	2.7. Organet shkollorë profesionale këmbëjnë përvojat profesionale për të përkrahur procesin e mësimnxënies dhe zbatimin e kurrikulës shkollorë.	
	2.8. Shkolla bashkëpunon me autoritetet kompetente sipas nevojave për zbatimin e kurrikulës.	
	2.9. Shkolla zbaton dispozitat ligjore që rregullojnë vlerësimin e nxënësve me bazë shkolle.	
Procesi i kurrikulës dhe mësimdhënies e mësimnxënie	2.10. Mësimdhënësit përdorin TIK-un dhe resurse tjera të mësimdhënies e mësimnxënies për të lehtësuar procesin mësimor të nxënësve.	
	2.11. Mësimdhënësit përdorin resurset e ndryshme të mësimdhënies, pa e kufizuar vetën vetëm në tekste shkollorë.	
	2.12. Mësimdhënësit ruajnë portfoliot e nxënësve për të përcjellë progresin e nxënësve.	
	2.13. Vlerësimi i arritshmërisë së nxënësve dhe vetë-vlerësimi i nxënësve e poashtu edhe vetë-vlerësimi zbatohen duke përdorur metoda, teknika dhe instrumente adekuate.	
	2.14. Nxënësit mësojnë përmes punës ekipore, përvojës personale dhe resurset e ndryshme që më së miri përshtaten me progresin e nxënësve.	
	2.15. Nxënësit përkrahen në mënyra të ndryshme nga mësimdhënësit për të siguruar resurset e mësimnxënies dhe për prezantimin e punës së nxënësve.	

Standardi 3: Mësimdhënësit janë të motivuar dhe kompetent për të vepruar në pajtim me kërkesat e profilit të kompetencave të mësimdhënësve.		
Komponentët shkollor	Treguesit	v, ≈, X
Menaxhimi dhe udhëheqja	3.1. Shkolla ka një rregullore të brendshme për mbikëqyrje dhe vlerësim të performancës së mësimdhënësve, që zbatohet rregullisht.	
	3.2. Shkolla ka procedura për përfshirjen mësimdhënësve në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve për zhvillimin e shkollës dhe planeve vjetore.	
	3.3. Shkolla ka një plan tre-vjeçar për aftësimin profesional të mësimdhënësve që është në harmoni me standardet dhe treguesit e shkollave mike për fëmijë dhe plani është në procesin e zbatimit.	
	3.4. Shkolla ka një sistem të rregullt të informimit për mësimdhënësit mbi projektet për zhvillimin e shkollës dhe aktivitetet tjera.	
	13.5. Drejtori i shkollës dhe shërbimi pedagogjik i shkollës mbikëqyrin punën e mësimdhënësve rregullisht dhe sigurojnë përkrahjen e nevojshme konstruktive dhe motivuese.	
Kapacitetet shkollore	3.6. Shkolla siguron të gjitha dokumentet për punën e mësimdhënësve dhe aftësimin e tyre profesional.	
	23.7. Shkolla zbaton kriteret për vlerësimin e performancës së shkollës.	
	3.8. Shkolla siguron që të gjithë mësimdhënësit kanë veglat e nevojshme për zbatimin e mësimdhënies efektive dhe përkrah krijimin e resurseve të mësimdhënies për mësimdhënësit.	
	3.9. Mësimdhënësit planifikojnë punën e tyre brenda departamenteve të tyre profesionale, i këmbëjnë përvojat dhe idetë e tyre për planifikimin e formave të ndryshme të komunikimit dhe bashkëpunimit.	
	3.10. Mësimdhënësit kanë plane vjetore, mujore, tematike dhe ditore që përmbajnë të gjitha elementet e nevojshme për organizim dhe zbatim të suksesshëm të njësive mësimore.	
	3.11. Shkolla ka raporte periodike brenda vitit shkollor për përcjelljen e planifikimit dhe zbatimit të punës së mësimdhënësve që përfshijnë informata për progresin e mësimdhënësve apo vështirësitë në atë fushë e poashtu edhe nevojat për përkrahje të mëtejme.	
Procesi i kurrikulës dhe mësimdhënies e mësimnxënies	3.12. Mësimdhënësit zbatojnë kompetencat për zbatimin e kurrikulës në praktikën e tyre të mësimdhënies.	

3.13. Mësimdhënësit zbatojnë në praktikën e tyre kompetencat për metodologjinë e mësimdhënies dhe vlerësimin e nxënësve, duke zbatuar praktikat e shkollës mike për fëmijë të identifikuar në të gjitha dimensionet.
3.14. Mësimdhënësit zbatojnë në praktikën e tyre kompetencat e përmbajtës akademike/lëndore.
3.15. Mësimdhënësit zbatojnë në praktikën e tyre të mësimdhënies kompetencat e teorisë së mësimnxënies, veçanërisht kur ata harmonizojnë mësimdhënien e tyre me stilet e mësimnxënies së nxënësve.
3.16. Mësimdhënësit zbatojnë në praktikën e tyre të mësimdhënies kompetencat e marrëdhënieve profesionale.

Ushtrimi 2: Pasi që keni kaluar nëpër të gjithë treguesit, nga lista e treguesve të cilat nuk janë arritur fare, zgjidhni 1-2 tregues dhe rendisni aktivitetet që do t'i ndërmerrni në ditët dhe javët në vijim që të arrihen me sukses ata tregues.

Standardi 1: Të gjithë nxënësit angazhohen aktivisht në procesin mësimor dhe mbështeten në zhvillimin e potencialeve të tyre.

Nr.	Treguesit	Aktivitetet për arritjen e treguesve

Standardi 2: Mundësitë, nevojat dhe interesat e nxënësve gjatë procesit mësimor janë në fokus të mësimdhënies që zbatohet me metodologji të ndryshme

Nr.	Treguesit	Aktivitetet për arritjen e treguesve

Standardi 3: Mësimdhënësit janë të motivuar dhe kompetent për të vepruar në pajtim me kërkesat e profilit të kompetencave të mësimdhënësve.

Nr.	Treguesit	Aktivitetet për arritjen e treguesve

Një përfundim të cilin mund ta nxjerrim nga shqyrtimi i cilësive të Shkollave Mike për Fëmijë është se ato i reflektojnë të gjitha cilësitë e një shkolle të mirë.

Fjalorthi

Arritshmëria – shkalla e përbushjes së objektivave të caktuar, për shembull, objektivat shkollorë, objektivat e projektit, objektivat e programit trajnues, objektivat mësimore, etj.

Çmuarja– është proces i dhënies së kuptimit asaj që është vëzhguar apo është bërë e dukshme përmes matjes së performancë (p.sh. mësimnxënia e nxënësve, cilësia e shkollës, etj.)

Efektiviteti – arritja e rezultateve të dëshiruara

Efikasiteti– arritja e një rezultati të paraparë duke përdorur sasinë më të vogël të mundshme të resurseve (d.m.th. para, materiale, kohë, ekspertizë, etj.)

Instrumenti i vlerësimit – një proces i përcaktuar i zhvilluar që të masë, vlerësojë dhe gjykojë cilësinë e një rezultati të arritur apo dëshiruar.

Kompetenca – kombinim dinamik i aftësive kongnitive dhe meta-kognitive, njohuritë dhe të kuptuarit, aftësitë ndërpersonale, intelektuale dhe praktike, dhe vlerat etike.

Kontrolli i cilësisë – Mekanizma dhe procedura të veçanta të përdorura për të siguruar që proceset e zbatuara të arrijnë rezultatet e dëshiruara përdoren në mënyrë efektive.

Mbikëqyrja– Një proces që iu ofron palëve të interesuara në të gjitha nivelet informim të vazhdueshëm mbi zhvillimet.

Monitorimi – është proces i krahasimit të vazhdueshëm të rezultateve të pritura me rezultatet faktike – Procedura të rregullta sistematike për mbledhjen e informatave për aspekte të ndryshme arsimore. Qëllimi i monitorimit është që të sigurojë efikasitetin dhe efektivitetin e punës së shkollës.

Standardet – janë deklaram i objektivave që përcaktojnë cilësinë e performancës; një grup deklaratash që përcaktojnë atë që individët duhet të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë në përbushjen e roleve të tyre; një grup deklaratash që përcaktojnë cilat janë nivelet e pritura dhe të arritshme të arritshmërisë.

Treguesit– *Veprime të dukshme*, sjellje apo dëshmi tjetër që tregon praninë, gjendjen apo gjendjet që ndërliken me standarde. Treguesit mund të përdoren për vlerësim të zhvillimit drejt arritjes së standardeve.

Treguesit e cilësisë –Diçka që tregon se një gjendje është e përafërt me cilësinë apo rezultatin e dëshiruar.

Vetë-vlerësimi – është proces gjatë të cilit një institucion, agjenci, program apo individ mbledh informata për vete dhe gjykon cilësinë dhe vlerën e performancës.

Vëzhgimi –është proces i vëzhgimit të individëve që bëjnë një aktivitet të caktuar, apo gjatë ngjarjeve dhe situatave të ndryshme në mjedise të ndryshme, dhe në shkollë.

Vlerësimi– është gjykim i cilësisë apo vlerës së rezultateve të arritura në lidhje me një rezultat apo proces të paraparë; p.sh. matje e kompetencave të nxënësve, apo vlerësim i cilësisë së një procesi siç është mësimdhënia.

Referencat

- Grup autorësh (2006): Arsimi fillor cilësor, Qendra për Arsim e Kosovës, Prishtinë.
- Ainscow, M., et al, "Përmirësimi i shkollës, zhvillimi i gjithëpërfshirjes", 2006
- Booth, T., et al, "Indeksi i gjithëpërfshirjes", 2006
- Dr. Dorit Stenke (2008): Bazat e vlerësimit, ligjëratë e mbajtur me zyrtarët e Ministrisë së Arsimit, Prishtinë.
- Elisabeth Backman dhe Bernard Trafford (2007): Udhëheqja demokratike e shkollave, Këshilli i Evropës, Strasburg.
- Fullan, M. (1999): Forca e ndryshimit në arsim, Adea, Prishtinë.
- Fullan, M. (2001): Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim, Edualpa, Prishtinë.
- Goddard, T., Duraku, N., Binaku, Xh. (2006): Informatat mbi menaxhimin në arsim, Udhëzues për trajnerë, KEDP, Prishtinë.
- Grillo, prof.dr. Kozma (2002): Fjalor arsimor (Psikologji-Sociologji-Pedagogji), "Drita 2000", Prishtinë.
- H.W. Baumann (2004): Shkolla e mirë, GTZ, Prishtinë.
- Hyseni, H., Salihaj, J., Nikoleta, M., Pupovci, D., (2003): Udhëheqja dhe menaxhimi në arsim, KEC, Prishtinë.
- Liana Gertsch, "Kuptimi i gjërave bazë – Kontributi i zhvillimit të hershëm të fëmijëve në cilësinë, barazinë dhe efikasitetin në arsim", 2009
- UN Girls' Education Initiative et al. « Barazia dhe gjithëpërfshirja në arsim », 2010
- UNESCO, "Barazia dhe gjithëpërfshirja në arsim – Veglat për përkrahur planifikimin dhe vlerësimin e sektorit të arsimit", 2008
- Ministria e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë (2011): Korniza e Kurrikulës për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, Prishtinë.
- UN Girls' Education Initiative et al. « Barazia dhe gjithëpërfshirja në arsim », 2010
- UNESCO, "Barazia dhe gjithëpërfshirja në arsim - Veglat për përkrahur planifikimin dhe vlerësimin e sektorit të arsimit", 2008

